

UNIVERSITETI I EJL
ЈНЕ УНИВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY

Universiteti i Europës Juglindore
Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore

**Marrëdhëniet e Republikës së Maqedonisë me fqinjët pas
vitit 2001**

- Teza e magistraturës -

Mentori i Tezës:
Prof. Dr. Jonuz Abdullai

Studenti:
Zuhri Veseli
ID:127703

Tetovë, 2020

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT 4

АИСТРАКТ 5

HYRJE 6

Qëllimi i punimit 6

Hipoteza gjenerale dhe hipotezat ndihmëse 7

Metodologjia dhe metodat 8

KAPITULLI I:

Marrëdhëniet ndërkombëtare nga aspekti teorik 9

1.1. Definicionet dhe nocionet e marrëdhënieve ndërkombëtare 9

1.2. Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe politika e jashtme 14

1.3. Relacionet e institucioneve shtetërore diplomatike në skenën ndërkombëtare 16

KAPITULLI II:

Republika e Maqedonisë prej pavarësisë deri më sot 21

2.1 Pavorsia e R. së Maqedonisë 21

2.2 Konflikti i armatosur ndëretnik në vitin 2001 28

2.3 Marrëveshja kornizë e Ohrit si zgjidhje e konfliktit të armatosur ndëretnik 41

KAPITULLI III:

Republika e Maqedonisë në skenën ndërkombëtare dhe raportet me fqinjët 46

3.1 Raportet midis R. së Maqedonisë dhe R. së Shqipërisë 46

3.2 Raportet midis R. së Maqedonisë dhe R. së Kosovës 59

3.3 Raportet midis R. së Maqedonisë dhe R. së Serbisë 65

3.4 Raportet midis R. së Maqedonisë dhe R. së Bullgarisë 71

3.5 Raportet midis R. së Maqedonisë dhe R. së Greqisë	81
3.5.1 Marrëveshja e Prespës e vitit 2018	91

KAPITULLI IV:

Rezultatet e hulumtimit	97
1. Të anketuarit dhe ekzemplarë	97
2. Rezultatet e hulumtimit dhe analiza	98

PERMBYLLJE	125
-------------------	-----

Literatura e konsultuar	128
--------------------------------	-----

Shtojca	130
----------------	-----

ABSTRAKT

Periodha kohore prej vitit 2001 deri në vitin 2020 do të mbahet mend për rrjedhojën e ndodhive në R. e Maqedonisë, qoftë në aspektin e krijimit të politikave të jashtme në nivel bilateral dhe multilateral, poashtu edhe në aspektin e krijimit të politikave të brendshme. Kjo periudhë kohore karakterizohet me ngjarje të natyrave të ndryshme duke u nisur nga konfliktet ndëretnike dhe duke përfunduar me marrëveshjet. Ngjarja që bëri kthesë në historinë bashkohore të R. së Maqedonisë ishte konflikti i armatosur i vitit 2001 mes forcave të UCK-së dhe forcave policore maqedonase që si pasojë të ketë përmbyllje me një marrëveshje që u titullua *“Marrëveshja kornizë e Ohrit”* e inicuar nga faktori ndërkombëtar. MO konsiderohet baza për një sistem të ri të ndarjes së pushtetit dhe ristrukturimit të brendshëm të Maqedonisë, kryesisht përmes ndryshimeve kushtetuese, miratimit të ligjeve të reja dhe rishikimit të ligjeve të vjetra. Me këtë marrëveshje filloi progresi i politikbërjes së brendshme duke u angazhuar që çdo pikë dhe presje e kësaj marrëveshje të realizohet; *“Ndërprerja e armiqësive”* *“Zhvillimi i një qeverie të decentralizuar”*, *“Mosdiskriminimi dhe përfaqësimi i drejtë”*, *“Procedurat speciale parlamentare”*, *“Edukimi dhe përdorimi i gjuhëve”*, *“Shprehja e identitetit”*, *“Ndryshimet legjislative” etj*

“Marrëveshja e Prespës” ishte edhe një hap tjetër i progresit politik në politikën e jashtme, kështu duke rregulluar marrëdhëniet e “lashta” me R. e Greqisë për çështjen e kontestit shumëvjeçar të emrit dhe si pasojë e së cilës R. e Maqedonisë ndryshoi emrin në Republika e Maqedonisë së Veriut. Pas afër 20 vjet rrugëtim të gjatë, R. e Maqedonisë së Veriut arriti ti bashkangjitet familjes së madhe të NATO-s duke u bërë antare e 30-të e saj dhe arriti të merr datë për negociatën me BE.

Ky hulumtim do të paraqesë sfidat dhe përpjekjet 20 vjeçare të R. së Maqedonisë së Veriut deri te aritja e sukseseve në plan të jashtëm dhe të brendshëm duke tejkaluar të gjitha krizat që e tangonin historikisht si çështja e emrit të shtetit, gjuhës, kishës, kulturës, historisë etj, duke u angazhuar që opinionit publik ti ofrojmë një pasqyrë reale të ngjarjeve për ecurinë e proceseve në raport me shtetet fqinje

Fjalët kyçe: *Maqedonia, NATO, BE, Marrëdhëniet, Fqinjët*

АПСТРАКТ

Периодот од 2001 до 2020 година ќе биде запаметен за исходот од настаните во Република Македонија, како во однос на креирање на надворешна политика на билатерално и мултилатрално ниво, така и креирање на домашната политика. Овој временски период се карактеризира со настани од различна природа, почнувајќи од меѓуетнички конфликти до склучување на договори. Настанот што направи пресврт во современата историја на Република Македонија беше вооружениот конфликт во 2001 година меѓу вооружените сили на ОВК и македонските полициски сили, што резултираше со постигнат договор по наслов „Охридски рамковен договор“ инициран од меѓународниот фактор. ОРД се смета за основа за нов систем на поделба на овластувањата и внатрешно реструктуирање на Македонија, главно преку уставни измени, донесување на нови закони и ревизија на старите закони. Со овој договор започна напредокот во креирањето на внатрешната политика, обврзувајќи се да се реализира секоја точка и записка на овој договор; „Престанок на непријателствата“, „Развој на децентрализирана власт“, „Недискриминација и правична застапеност“, „Специјални парламентарни процедури“, „Образование и употреба на јазици“, „Изразување на идентитет“, „Законодавни измени“ итн.

„Преспанскиот Договор“ беше уште еден чекор во политичкиот напредок во надворешната политика, со што беа регулирани „древните“ односи со Република Грција во врска со долгогодишниот спор за името како последица на тоа што Република Македонија го смени своето државно име во Република Северна Македонија. По скоро 20 години долгиот пат, Република Северна Македонија успеа да се приклучи на големото семејство на НАТО со тоа што стана нејзина 30-та членка и успеа да добие датум за преговори со ЕУ.

Во ова истражување ќе бидат претставени предизвиците и напорите на Република Северна Македонија повеќе од 20 години до постигнувањето на успеси на внатрешен и надворешен план, надминување на сите кризи што историски влијаат врз неа, како што е прашањето за името на државата, јазикот, црквата, културата. историјата и сл., се со цел да и се обезбеди на јавноста реален преглед на развојот на процесите во однос на соседните држави. **Клучни зборови:** *Македонија, НАТО, ЕУ, Односи, соседи*

HYRJE

Aktualiteti i tezës së magistraturës me titull “Marrëdhëniet e Republikës së Maqedonisë me fqinjët pas vitit 2001” rrjedh si pasojë e asaj që e njejta është temë me interes për shoqërinë tonë dhe opinionin e gjërë publik. Shumë nga ne, si banorë të këtij shteti, mendojnë se marrëdhëniet e mira me disa shtete fqinje, dhe me disa të tjera, të dobëta, vijnë si rezultat i divergjencave në komentimet e fakteve historike dhe gabimeve politike që ndërmerren për tejkalimin e ndryshimeve.

Me qëllim që të pasqyrohen shkaqet se pse R. e Maqedonisë ka marrëdhënie të mira me disa nga shtetet fqinje, e me disa jo, në këtë tezë do të bëhet analizë detajore, e cila do të përbëhet nga aspekti teorik, poashtu edhe nga aspekti hulumtues i cili do të realizohet me anë të pyetësorit anketues. Njëashtu, në këtë tezë do të jepet edhe një pasqyrim i shkurtër i marrëdhënieve bilaterale dhe multilaterale të R. Së Maqedonisë me fqinjët e saj, respektivisht, me R. E Shqipërisë, R. E Kosovës, R. E Sërbisë, R. E Bullgarisë dhe R. E Greqisë.

Qëllimi i punimit

Në këtë punim, qëllimi kryesorë është të bëhet një hulumtim kualitativ i cili do të bazohet në argumente, analiza, si dhe në të dhëna të vërteta shkencore. Qëllim tjetër i punimit është që të analizohen disa fakte të njohura dhe më pak të njohura historike, gjeografike dhe politike që ndërliken me marrëdhëniet e R. së Maqedonisë me vendet fqinje.

Gjithashtu, në këtë hulumtim, do të realizohet edhe analiza e disa fakteve dhe argumenteve që ndërliken me R. E Maqedonisë në raport me marrëdhëniet nderkombëtare dhe politikën e jashtme, nëpërmjet të së cilës do të mund të shihen përparësitë, mangësitë dhe ngecjet e R. Së Maqedonisë në skenën nderkombëtare.

Hulumtimi thelbësorë i prejardhjes së emrit të shtetit, gjuhës, kishës, kulturës, historisë dhe ndikimi i tyre në rregullimin e marrëdhënieve shtetërore me fqinjët, gjithashtu do të jetë objekt analize në këtë punim, e poashtu paraqet edhe motivacion për punë.

Hipoteza gjenerale dhe hipotezat ndihmëse

Në këtë tezë magjistrature është paraqitur një hipotezë gjenerale (kryesore) dhe disa hipoteza ndihmëse.

Hipoteza gjenerale paraqet: “R. e Maqedonisë ka marrëdhënie shumë të mira me fqinjët ku kryesisht jetojnë popullatë shqiptare, si R. e Shqipërisë dhe R. e Kosovës, e nga ana tjetër, ekzistojnë disa problematika të thella dhe pengesa politike me shtetet fqinje që nuk janë të banuara me popullatë shqiptare, si, R. E Sërbisë, R. E Bullgarisë dhe R. E Greqisë”

Hipotezat ndihmëse:

R. e Maqedonisë ka mospajtime me R. e Bullgarisë që ndërlidhen me çështjen e gjuhës dhe historisë;

R. e Maqedonisë ka problem me R. e Sërbisë në sferën fetare, shkak i së cilës është mospranimi i autoqefalitetit të kishës ortodokse maqedonase;

R. e Maqedonisë ka probleme serioze me fqin jugor, respektivisht me R. e Greqisë që ndërlidhet me emrin e shtetit;

R. e Maqedonisë mban trendin për tejkalimin e mosmarrëveshjeve të ndryshme politike me të cilat ballafaqohet

R. e Maqedonisë, deri sot, ka të arritura të caktuara dhe suksese në skenën politike ndërkombëtare, gjegjësisht në marrëdhëniet me fqinjët.

Metodologjia dhe metodat e punimit

Korniza metodologjike e punimit do të posedojë një radhitje logjike dhe disa hulumtime shkencore të cilat do ta ndjekin rrugën e cila çon drejt të vërtetës nëpërmjet argumenteve të shëndosha të cilat do të mundësojnë përforcim ose hudhje të kornizës së vendosur hipotetike.

Në bazë të asaj që theksuam paraprakisht, në këtë hulumtim, do të përdoren disa metoda, si që janë:

- Metoda e analizës dhe sintezës;
- Metoda historike;
- Metoda komparative (krahasuese);
- Metoda statistikore;
- Metoda e intervistës;

Kemi bindjen që ky punim shkencorë do të ketë domethënie të veçantë teorike, shkencore dhe praktike.

Domethënia teorike-shkencore përbëhet nga ajo që ky punim magjistrature do të mund të kontribuojë në krijimin e urave lidhëse ndërmjet shteteve fqinje që të shihet se problemet ekzistuese nuk janë edhe aq të mëdha si që paraqiten, ndërsa domethënia praktike përbëhet nga ajo që ky punim magjistrature do të ofrojë informata të mira dhe praktike, si dhe dituri që ndërlidhen me marrëdhëniet e R. së Maqedonisë me fqinjët, por edhe angazhim të faktorëve relevant në skenën ndërkombëtare, me qëllim që të gjinden zgjidhje të mundëshme eventuale për tejkalimin e problemeve politike.

KAPITULLI I

Marrëdhëniet ndërkombëtare nga aspekti teorik

1.1 Definicionet dhe nocionet e marrëdhënieve ndërkombëtare

Fusha e së drejtës ndërkombëtare kryesisht ka të bëjë me normat juridike të cilat ndikojnë në mes popujve (shpesh të quajtura “shtete”), por, ajo gjithashtu ka të bëjë me norma të caktuara juridike që ndikojnë ndërmjet një shteti dhe njerëz të caktuar në suaza të kompetencave të saj, dhe me disa norma të veçanta që i rregullon marrëdhëniet jashtëkufitare të njerëzve. Për dallim të legjislacionit nacional, e drejta ndërkombëtare, në masë të madhe është e decentralizuar; nuk ekziston trup ligjvënës, gjyqësi, ose organ ekzekutiv i cili do të jetë përgjegjës për krijimin, komentimin dhe realizimin e të drejtës ndërkombëtare, por ekzistojnë konglomerat të mënyrave nëpërmjet të cilave e drejta ndërkombëtare mundohet ti kryej ato funksione. Si të atilla, gjeneza dhe natyra e së drejtës ndërkombëtare janë jo të zakonshme dhe emocionale; sfera ia lejon një juristi të “mendojë jashtë të zakonshmes” për atë se çka paraqesin ligjet dhe si të njejtat e diktojnë sjelljen e njerëzve. Në të njejtën kohë, procesi i studimit të përgjithshëm në sferën e së drejtës ndërkombëtare, mund të zhvillohet me vite të tëra, sepse ngërthen një segment të gjërë të temave, duke filluar nga normat më të rëndësishme që mundohen të parandalojnë luftëra e deri te ato më pak dramatike që kanë të bëjnë me telefonatat trans-atlantike.¹

E drejta ndërkombëtare emrin e saj e ka marrë nga termi latin „jus gentium” (jus=e drejtë dhe gens=popull, gjegjësisht gentium (shumës= popuj) do të thotë e drejta e popujve, gjegjësisht e drejta ndërkombëtare. Objekt i së drejtës ndërkombëtare janë garniturë e rregullave juridike të cilat në mënyrë gjenerale janë të ndërlidhura me subjektet e të drejtës ndërkombëtare. Shpeshherë termi “E drejta Ndërkombëtare” identifikon veten me termin “E Drejta Ndërkombëtare Publike”. Mirëpo përsëri duhet të theksohet se me anë të shikimit rigoroz formal, E Drejta Ndërkombëtare është nocion më i gjërë që në vete ngërthen edhe të drejten ndërkombëtare private. Ashtuqë, përderisa, E Drejta Ndërkombëtare Publike i rregullon, parasëgjithash, marrëdhëniet ndërmjet shteteve, E drejta ndërkombëtare private i rregullon marrëdhëniet ndërmjet njerëzve me nënshtetësi të ndryshme në rastet e dilemave se cila e drejtë

¹ Sean, D. Murphy, “*Principles of International Law*” Concise hornbook series, Thomson West, f.9

nacionale duhet ta aplikohet në rastin konkret, a me ate edhe cili jurisdikcion është kompetent për ate dhe të ngjashme.

E drejta ndërkombëtare publike mund të jetë universale ose regjionale, respektivisht e domosdoshme (jus cogens) dhe dispozitive (jus dispositivum). E drejtë ndërkombëtare universale është ajo që vlen për të gjithë bashkësinë ndërkombëtare për dallim nga e drejta ndërkombëtare regjionale që vlen për shtetet që bëjnë pjesë në një hapësirë konkrete – regjion. Jus Cogens është pjesa “më e fuqishme” e të drejtës ndërkombëtare dhe në njëfar mënyre ka një forcë juridike të ngjashme që e ka kushtetuta në të drejtën e brendshme. Kjo e drejtë nuk mund të ndryshohet me marrëveshje tjera përveçse në mënyrën e njejtë ashtu si u krijua. Jus dispositivum është pjesa “më e butë” e së drejtës ndërkombëtare. Domethënë, vetëm vendosën standarde të caktuara të cilat shtetet duhet por nuk janë të obliguara ti respektojnë.

E drejta ndërkombëtare ka strukturë horizontale dhe vertikale. Struktura horizontale përbëhet nga shtetet e pavarura dhe sovrane. Kjo implikon që çdo shtet, të paktën formalisht, nuk është në varësi nga asnjë shtet tjetër e as ndonjë organizate ndërkombëtare, që do të thotë, një shtet përkatës që të jetë nën çfarëdoqoftë restriksioni doemos paraprakisht të jetë pajtuar vullnetarisht për të. Megjithatë, krahas strukturës horizontale gjithashtu ekziston edhe struktura vertikale e së drejtës ndërkombëtare. Ashtu ekzistojnë shembuj ku shtetet janë bashkuar me qëllim të krijimit të organizatave të caktuara ndërkombëtare, respektivisht supranacionale që kanë aftësi të krijojnë të drejtë me efekt detyrues ndaj antarëve të saj. Gjithashtu ekzistojnë edhe gjyqe ndërkombëtare dhe tribunale në vendimet e të cilave janë nënshtruar një numër i madh i shteteve me pajtueshmeri të dhënë paraprakisht.

Rënjët e së drejtës ndërkombëtare ndërlidhen me tokën evropiane, posaçërsisht me epokën e renesansës. Mirëpo, disa koncepte bazë të së drejtës ndërkombëtare mund të lokalizohen edhe më herët në interakcione të caktuara politike. Si psh. është e njohur marrëveshja e nënshkruar në pllakë gurri në mes udhëheqëve Lagash dhe Uma rreth vitit 3100 para erës sonë.² Bëhet fjalë për, ndoshta, marrëveshjen e parë ndërkombëtare për regullimin e kufijve në mes veti. Rreth 1000 vjet më vonë, hasim edhe në një shembull të marrëveshjes ndërkombëtare të nënshkruar këtë herë ndërmjet udhëheqësit të Egjiptit dhe mbretit të Hitëve. Me këtë marrëveshje palët obligohen

² Sean, D. Murphy, “*Principles of International Law*” Concise hornbook series, Thomson West, f.19

në respektimin e integritetit të ndërsjellë teritorial dhe vendosjen e një lloji të aleancës mbrojtëse ndërmjet tyre.

Në gjithë epokën e vjetër nuk ia kanë pasur idenë për bashkësi ndërkombëtare të shteteve që koegzistojnë në kornizë të caktuar. Për shkak të kësaj, diapazoni i “të drejtës ndërkombëtare” të atëhershme ka qenë shumë i kufizuar. I këtillë është edhe shembulli me Greqinë antike ku kanë ekzistuar shumë marrëveshje tregëtare dhe politike ndërmjet qyteteve-shtete helene që gjithashtu kanë kultivuar rregulla të caktuara që kanë pasur të bëjnë me të deleguarit diplomatik. Megjithatë, ky “rend ndërkombëtar” ka qenë i kufizuar vetëm për botën helene dhe kolonitë e saj, ndërsa ata jashtë saj, janë quajtur varvarë që nuk janë të denjë për bashkëpunim, e njashtu nuk kanë qenë të denjë edhe për lidhjen e kontratave ndërkombëtare.

Nga shekulli i mesëm, një nga mendimtarët më të spikatur që kanë kontribuar në krijimin dhe zhvillimin e të drejtës ndërkombëtare, paraqesim Fransisco de Vitoria (1486?-1546) ligjerat³ e të cilit janë publikuar pas vdekjes së tij nga studenti i tij Alberiko Xhentili (Alberico Gentili).

Si baba i të drejtës ndërkombëtare njihet Hugo Grotius. Vepra e tij më e rëndësishme është “De jure belli ac pacis” gjegjësisht “e drejta e luftës dhe paqes”. E ka shkruar rreth vitit 1623. Në këtë vepër flet për drejtësinë, projekton një sistem të tërë të imagjinuar ndërkombëtar juridik, largon teologjinë nga e drejta ndërkombëtare dhe meret me shpalljen e principit të lirisë së detit.⁴

Paralelisht me teoritë e juristëve ndërkombëtarë për të drejtën ndërkombëtare janë teoritë e marrëdhënieve ndërkombëtare për rolin e “normave” dhe “regjimeve” në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në shkallë të lartë, juristët ndërkombëtarë dhe specialistët për marrëdhënie ndërkombëtare veprojnë në sfera të ndryshme, por në vitet e fundit ata kanë parasyshtë punën e tëdyja palëve, që në shumë aspekte paraqet progres të përbashkët. Edhe pse puna e specialistëve për marrëdhënie ndërkombëtare është e ndryshueshme dhe nuk mundet lehtë të përmblihet, për punën mundet në mënyrë gjenerale të thuhet se i ndjekin një nga katër qasjet.

³ Sean, D. Murphy, “*Principles of International Law*” Concise hornbook series, Thomson West, f.23

⁴ Ibid, f.25

“Idealistët” e marrëdhënieve ndërkombëtare besojnë që shoqëria ndërkombëtare ka arritur në një fazë që aplikimi i forcës ushtarake nuk mban; shtetet bashkarisht ndajnë interese të fuqishme në koegzistencë të qetë. Ata inetez mund të progresohen nga ana e shteteve që synojnë drejtë strategjive kooperative nëpërmjet marrëveshjeve, organizatave ndërkombëtare dhe mekanizmave paqësore për zgjidhjen e kontesteve.

Idealizmi në SHBA kulminacionin e saj e arriti në vitet e hershme të shekullit të kaluar, kur shumë liderë influent amerikanë besonin që institucionet juridike dhe politike të krijuara në mënyrë të suksesshme në SHBA do të mund të rikrijoeshin në nivel ndërkombëtar, duke kontribuar me anë të tyre paqe botërore dhe prosperitet. Idealistët e tillë u përpoqën të themelojnë organizata ndërkombëtare si Liga e popujve dhe marrëveshje ndërkombëtare, si që është pakti Kellog-Briand i vitit 1928⁵, ku shtetet me të drejtë e kodifikuan idenë se aplikimi i dhunës ushtarake për arritjen e qëllimeve të caktuara, nuk lejohet. Botëkuptimi i këtyllë (gjithashtu me nënçmim i ashtuquajtur “utopizëm”) që mbeti dominant në SHBA vitet e 20-ta dhe 30-ta të shek. XX, humbi dashamirësinë kur përpjekjet e tilla nuk mundën ta ndalojnë shpërthimin e Luftës së Dytë Botërore. Idealizmi ende ishte i theksuar në marrëdhëniet e jashtme të SHBA; disa e kuptuan nga fjalimi i George Washington (George W. Bush), në fjalimin e tij të dytë përurues ku ai fliste për SHBA i cili do të angazhohet për promovim energjik të demokracisë në nivel botëror. Politika e jashtme evropiane përmban elemente të fuqishme idealiste, ndoshta për shkak se krijimi i institucionit supra-nacional (unioni evropian) arriti ti jepte fund konfliktit në mes të vendeve evropiane që filluan dy luftëra botërore.

“Realistët” e marrëdhënieve ndërkombëtare, numri i të cilëve u rrit pas Luftës së Dytë Botërore, në mënyrë gjenerale mendojnë se nuk ekziston harmoni esenciale e interesave ndërmjet shteteve, por më shumë rrjet i qëllimeve konfliktuoze nacionale në një botë anarhike. Për realistët klasik, fuqia e mundësive shtetërore, në vend të interesave të përbashkëta, i diktojnë marrëdhëniet ndërmjet shteteve, dhe vetëm me anë të balansit të fuqisë mundet në mënyrë efektive të arrihet harmoni. Bashkëpunim në mes shteteve mund të ndodhë kur intereset e tyre janë kompatibil, megjithatë bashkëpunimi i tillë nuk është prodhim i principeve morale dhe etike që shpërndahen në mënyrë univverzale nga të gjithë shtetet, por është produkt i supozimeve të caktuara paraprake për natyrën njerëzore; ata njerëz që udhëheqin me shtetet kërkojnë pasuri dhe

⁵ Janev, Igor “*Theory of international relations and foreign politics*”. publ.: “Plato”, Belgrade, 1998

fuqi, dhe do ti përdorin të drejtën ndërkombëtare dhe institucionet vetëm atëherë kur do të përfitojnë nga ajo. Në atë mënyrë, bashkëpunimi ndërmjet shteteve është proces fluid i politikës së ndryshueshme, që nuk është pjesë e kornizës ligjore stabile drejtë të cilës shtetet doemos të përmbahen.

“*Neo-realizmi*” dallohet nga realizmi klasik me atë që mundohet të sjellë favor më sistematik ose strukturorë nga marrëdhëniet ndërkombëtare, e kundërta e përshkrimit të etikës së diplomacisë. Për shëmbull, regjimet ndërkombëtare ekonomike (si që është Banka Botërore) janë pasqyrim i fuqisë strukturore në sistemin ndërkombëtar, duke iu lejuar disa shteteve të fuqishme ti shërbejnë interesave të tyre duke kontrolluar dhe siguruar stabilitetin e ekonomisë globale.

Teoreticienët e “*marrëdhënieve ndërkombëtare liberale*” pranojnë disa nga parimet kryesore të realizmit, por të njejtën e shohin si të pafuqishëm për ta sqaruar në tërësi sjelljen e shteteve. Teoreticienët liberal kanë bindjen se, ashtu si shtetet modernizohen dhe largohen nga luftimet e zakonshme, promovimi i mirëqenies ekonomike dhe sociale bëhet më i rëndësishëm se ruajtja e sigurisë së një vendi, e me atë, bashkëpunimi ndërmjet shteteve me anë të marrëveshjeve dhe organizatave ndërkombëtare bëhet më real se sa paraqitja e konfliktit. Për teorinë liberale të marrëdhënieve ndërkombëtare, shtetet nuk janë të njehta për nga natyra; ata me tradita demokratike dhe përkushtim ndaj shtetit të së drejtës i qasen marrëdhënieve ndërkombëtare ndryshe nga shtetet që nuk i kanë këto karakteristika. Në përgjithësi, shtetet demokratike nuk shkojnë në luftë kundër njëri-tjetrit dhe ato gjejnë mënyra të sofistikuar të bashkëpunimit ndërkufitar. Për më tepër, teoricienët liberalë besojnë se realistët nuk arritën të japin një shpjegim për individët dhe OJQ-të në marrëdhëniet ndërkombëtare. Këta aktorë kryesorë u kanë dhënë një dimension të ri (dhe më pak të përqendruar shtetit) perceptimit të tyre për politikën ndërkombëtare.

“*Konstruktivizmi*” në vetvete nuk mbështet ndonjë teori të rëndësishme të marrëdhënieve ndërkombëtare, por përkundrazi kritikon teoricienët e tjerë për dështimin për të marrë parasysh përmbajtjen e plotë dhe burimet e interesave të shtetit. Për konstruktivistët, sistemi ndërkombëtar paraqet konstruksion ideor të aktorëve shtetërorë, në të cilat ekzistojnë bindje të përbashkëta inter- subjektive (ide, koncepte, supozime). Shtetet “plotësohen” me njëri- tjetrin në marrëdhëniet mes tyre; koncepti si që është “sovranitet” objektivist jo i vërtetë, por është prodhim i shteteve të cilët vazhdimisht e definojnë dhe ridefinojnë nëpërmjet interakcioneve (bashkëveprimeve)

sociale. Për tu kuptuar në tërësi “interesat” e shteteve, njeriu duhet ta kuptojë vetëdijen njerzore dhe rolin e saj në shoqërinë ndërkombëtare, sepse ajo arrin të sqarojë se pse disa norma- si që është norma e cila pranon përdorimin e dhunës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut- mund të paraqitet brenda shoqërisë së shteteve.⁶

Të gjitha këto teori të marrëdhënieve ndërkombëtare japin argumente të rëndësishme për mënyrën se si shtetet dhe njerëzit veprojnë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Për të kuptuar plotësisht pse shtetet krijojnë traktate dhe organizata ndërkombëtare, ose norma dhe regjime të tjera, është e dobishme të kuptohen bazat e këtyre teorive, si dhe ato që i kritikojnë ato.

1.2. Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe politika e jashtme

Marrëdhëniet ndërkombëtare janë një disiplinë akademike që përqendrohet në studimin e bashkëveprimit të aktorëve në politikën ndërkombëtare, përfshirë shtetet dhe aktorët jo-shtetërorë si Kombet e Bashkuara (KB), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Botërore dhe Amnesty International. Një nga karakteristikat kryesore të sistemit ndërkombëtar është se ai është një gjendje anarkie - çdo shtet në sistem është sovran dhe nuk ka pse t'i përgjigjet autoritetit më të lartë.

Marrëdhëniet ndërkombëtare paraqesin studimin e marrëdhënieve të shteteve me njëra-tjetrën, me organizata ndërkombëtare dhe entitete të caktuara nën-kombëtare (psh burokracitë, partitë politike dhe grupet e interesit).

Marrëdhëniet ndërkombëtare merren me marrëdhëniet përtej kufijve të shteteve të kombeve. Ajo adreson ekonominë politike ndërkombëtare, qeverisjen globale, marrëdhëniet ndërkulturore, identitetet kombëtare dhe etnike, analizën e politikës së jashtme, studimet e zhvillimit, mjedisin, sigurinë ndërkombëtare, diplomacinë, terrorizmin, median, lëvizjet sociale dhe më shumë. Marrëdhëniet ndërkombëtare po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme pasi bota

⁶ Janev, Igor, “*Theory of international relations and foreign politics*”. publ.: “Plato”, Belgrade, 1998

rritet dhe ato janë gjithnjë e më të ndërlidhura përmes tregtisë, migracionit, Internetit dhe mediave sociale.⁷

Marrëdhëniet ndërkombëtare përpiqen të shpjegojnë bashkëveprimet e shteteve në sistemin global ndërshtetëror dhe gjithashtu po përpiqen të shpjegojnë bashkëveprimet e të tjerëve, sjellja e të cilëve buron nga një vend dhe drejtohet te anëtarët e vendeve të tjera. Shkurt, studimi i marrëdhënieve ndërkombëtare është një përpjekje për të shpjeguar sjelljen që ndodh përtej kufijve të shteteve, marrëdhëniet më të gjera të së cilës janë pjesë e një sjelljeje të tillë dhe institucioneve si private, shtetërore, joqeveritare dhe ndërqeveritare, të cilat mbikëqyrin ato ndërveprime.⁸

Marrëdhëniet ndërkombëtare (shpesh referuar çështjeve ndërkombëtare) kanë një qëllim të gjërë në shoqërinë moderne pasi kërkojnë të bëjnë të mundur kuptimin:

- Origjina e luftës dhe ruajtja e paqes
- Natyra dhe ushtrimi i fuqisë brenda sistemit global
- Karakteri i ndryshueshëm i aktorëve shtetëror dhe joshtetëror të përfshirë në vendimmarrje ndërkombëtare.

Për shembull, disa institucione mund të studiojnë mendimin socio-psikologjik që qëndron pas aktiviteteve të krijuesve të politikave të jashtme, ndërsa të tjerët mund të përqendrojnë studimet e tyre ndërkombëtare në proceset institucionale që kontribuojnë në qëllimet dhe sjelljen e shteteve. Kjo pra është fusha e studimit të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe varet nga qëllimet ose objektivat e organizatës.

Edhe pse marrëdhëniet ndërkombëtare po marrin kuptim të ri për shkak të botës gjithnjë e më të ndërlidhur, sigurisht që nuk është një koncept i ri. Historikisht, vendosja e traktateve midis

⁷ Department of International Relations, San Francisco State University, What is IR? California, USA, <https://internationalrelations.sfsu.edu/what-ir> vizituar më: 21.01.2020

⁸ Department of Political Science, International Relations, University of Wisconsin-Madison, <https://polisci.wisc.edu/fields/international-relations> vizituar më: 21.02.2020

kombeve ishte forma më e hershme e marrëdhënieve ndërkombëtare. Marrëdhëniet ndërkombëtare në botën e sotme janë të rëndësishme për shumë arsye:⁹

- *Marrëdhëniet ndërkombëtare* promovojnë politika të suksesshme tregtare midis kombeve.

- *Marrëdhëniet ndërkombëtare* nxisin udhëtimin, turizmin dhe imigrimin në lidhje me biznesin, duke u dhënë njerëzve një mundësi për të përmirësuar jetën e tyre.

- *Marrëdhëniet ndërkombëtare* i lejojnë shtetet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, të bashkojnë burime dhe të ndajnë informacionin si një mënyrë për të përballuar çështjet bashkëkohore globale që përfshijnë pandemitë, terrorizmin dhe krimin e organizuar transnacional.

- *Marrëdhëniet ndërkombëtare* afirmojnë kulturën njerëzore përmes shkëmbimeve kulturore, diplomacisë dhe zhvillimit të politikave.¹⁰

Politika e jashtme është një term që më së shpeshti përdoret si sinonim i diplomacisë. Ai përbëhet nga aktivitetet e politikës së jashtme të qeverisë si: vendime, programe, strategji dhe veprime në lidhje me subjektet dhe çështjet e politikës së jashtme, kryesisht me shtetet tjera ose organizatat ndërkombëtare. Drejtimet kryesore të politikës së jashtme janë *politika bilaterale* dhe *multilaterale* dhe programet për mbrojtjen dhe promovimin e synimeve dhe interesave të përcaktuara të politikës së jashtme të një shteti në terma ndërkombëtarë, d.m.th. në marrëdhëniet ndërkombëtare. Si rregull, organizatat ndërkombëtare nuk kanë një politikë të jashtme klasike (me përjashtim të BE). Për organizatat ndërkombëtare, termi “*marrëdhënie të jashtme*” zakonisht përdoret kur aktivitetet politike i referohen subjekteve jashtë kornizës së anëtarësimit të organizatës si një person juridik.¹¹

⁹ Byman, D. “*Deadly Connections: States that Sponsor Terrorism*”. Cambridge University Press, 2005, f. 73

¹⁰ Ekmekci, F. (2011). “*Terrorism as war by other means: national security and state support for terrorism*”. Revista Brasileira de Política Internacional, vol.54(1), f. 125 - 141.

¹¹ Janev, I., “*International relations and foreign politics (with the example of Yugoslav relations with the United Nations)*”, Institute of Political Studies, Belgrade, 2002.

1.3. Relacionet e Institucioneve diplomatike shtetërore në skenën ndërkombëtare

Diplomacia është arti dhe praktika e negociatave ndërmjet përfaqësuesve të grupeve ose vendeve. Zakonisht i referohet diplomacisë ndërkombëtare, duke kryer marrëdhënie ndërkombëtare përmes ndërmjetësimit të diplomatëve profesionistë për çështje të paqes, vendimmarrjes, tregtisë, luftës, ekonomisë, kulturës, mjedisit dhe të drejtave të njeriut. *Traktatet ndërkombëtare* zakonisht negocohen me diplomatët përpara se të pranohen nga politikanët kombëtarë. Në kuptimin joformal ose shoqëror, diplomacia është vendosja e taktikës për të fituar avantazh strategjik ose për të gjetur zgjidhje reciprokisht të pranueshme për një sfidë të përbashkët, një grup mjetesh që shprehin raportimin në një mënyrë jo konfrontuese, ose të sjellshme.

Në kontekstin e mënyrës së funksionimit të diplomacisë, ekzistojnë dy lloje të diplomacisë: *bilaterale* ose dypalëshe (midis dy vendeve) dhe *multilaterale* ose shumëpalëshe (midis disa vendeve ose organizatave). Epoka e multilateralizmit pas Luftës së Ftohtë është karakterizuar nga agjendat më komplekse të konferencave dhe bisedimeve me një numër në rritje të çështjeve dhe përfshirje të shtuar të ekspertëve, qytetarëve, grupeve dhe OJQ-ve.

Diplomacia shumëpalëshe po përpiqet të përshtatet me kushtet e reja. Sidoqoftë, ky proces është i ngadaltë dhe shumë aspekte të diplomacisë shumëpalëshe ende duhet të rishikohen, duke filluar nga çështjet procedurale dhe metodologjike.

Është interesante të analizohet koncepti i diplomacisë me konceptin e politikës së jashtme. Për shumë njerëz nuk është gabim të përdoret termi “politikë e jashtme” në vend të “diplomacisë” ose anasjelltas. Sidoqoftë, megjithëse midis tyre ekziston një pjesë e madhe e ndërvlarësisë, të dy termat janë të ndryshëm. Kështu, një vend që dëshiron të ketë një politikë aktive të jashtme do të investojë mjaft logjikisht në krijimin e diplomacisë së tij të shumtë dhe me përvojë. E kundërta është gjithashtu mjaft e logjishme, d.m.th nëse një vend ka diplomaci të fortë, diplomatë të shumtë dhe me përvojë, atëherë ajo ka tendencë të ketë një politikë aktive të jashtme. Sidoqoftë, termi “politikë e jashtme” është më i gjerë se termi “diplomaci”. Kjo do të thotë, diplomacia është mjeti i pashmangshëm dhe mbase më i rëndësishmi, e politika e jashtme shërben për arritjen e qëllimeve të paracaktuara. E thënë thjesht, diplomacia nuk ekziston vetëm, por vihet në shërbim të politikës së jashtme. Pra, politika e jashtme është ajo që dikush dëshiron

të arrijë, d.m.th., ai përcakton qëllimet e dëshiruara, ndërsa diplomacia është mënyra e zgjedhur për të ndjekur të njëjtat synime.

Është e dobishme të merret në konsideratë marrëdhënia e diplomacisë me formimin e politikës së jashtme të përgjithshme të një shteti, pra shkallën e ndikimit të diplomacisë në formimin e politikës së jashtme. Shumica e teoricientëve pajtohen që diplomacia nuk ka monopol në formimin e politikës së jashtme, por merr pjesë indirekt përmes mënyrës se si negociohet dhe mbrohet politika e jashtme e një vendi para anëtarëve të tjerë të bashkësisë ndërkombëtare. Ndërsa institucione të tilla si kreu i shtetit, kreu i qeverisë, ministri i jashtëm etj. drejtpërdrejt formojnë politikën e jashtme, diplomati, qoftë si përfaqësues i përhershëm i vendit të tij në një vend tjetër, ose si negociator në emër të vendit të tij në diskutime diplomatike për çështje specifike, transmeton, dhe nëse është e nevojshme, interpreton vendimet e vendit të tij që të kuptohet siç duhet në vendin në të cilin kryen misionin e tij diplomatik. Pra, diplomati nuk krijon politikën e jashtme të vendit të tij, por thjesht shpjegon, interpreton, justifikon atë dhe kështu me radhë. Sidoqoftë, diplomatët mund të ndikojnë në mënyrë indirekte në formulimin e vetë politikës së jashtme ose duke shprehur pikëpamjet e tyre të mbështetura nga autoriteti i përvojës së tyre brenda vendit të tyre, ose duke e bërë këtë përmes kryerjes së negociatave të caktuara jashtë vendit të tyre.

Nga kjo më sipër mund të shohim se si përcaktohet diplomacia. Ekzistojnë disa përkufizime për diplomacinë. Në përgjithësi, *diplomacia* është aftësia për të negociuar midis përfaqësuesve të shteteve ose grupeve. Kështu, sipas Vukadinoviç, diplomacia mund të përkufizohet edhe si një veprimtari shoqërore e organizuar siç duhet, qëllimi kryesor i së cilës është të përfaqësojë shtetin në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe të punojë për arritjen e qëllimeve të politikës së jashtme të shtetit me mjete paqësore.¹²

Nëse shikoni historinë e skenës ndërkombëtare është e lehtë të shihet se pothuajse nuk kishte asnjë fazë në marrëdhëniet ndërkombëtare ku nuk kishte asnjë veprim diplomatik. Megjithatë fillimet e diplomacisë datojnë në Italinë veriore në shekullin XIII, ende kemi një lloj fillimi të diplomacisë në kohërat antike. Në qytet-shtetet e lashta Greke, “diplomatët” u dërguan në qytet- shtetet e tjera për të diskutuar dhe zgjidhur çështje specifike pa pasur një përfaqësim

¹² Vukadinović, R. “*Megjunarodni politički odnosi*”, Zagreb, 1998, f. 186

diplomatik të përhershëm në ato qytet-shtete. Diçka e ngjashme me diplomatët e sotëm në Greqinë e lashtë ishte titulli “proxenos”. Ky titull iu dha një personi që jetonte në një qytet-shtet të caktuar, por kishte dhe mbante lidhje të ngushta me qytetin-shtet që i dha atij të njëjtin titull. Ndoshta diplomatët e parë të përhershëm të huaj në një vend tjetër ishin të ashtuquajturat “apocrisiarii”. Ata ishin një lloj i dërguari i përhershëm i Papës Romak në Kostandinopojë.

Me kalimin e kohës, është paraqitur nevoja që secili shtet serioz të ketë përfaqësuesit e vet, të cilët do të ishin “sytë dhe veshët” e tij në shtetin tjetër dhe do të informonin gjendjen vendase për ngjarjet në shtetin e huaj. Por me ardhjen e komunikimit modern, dilema është ngritur nëse diplomatët në vendet e tjera janë ende të nevojshëm në një kohë kur informacioni është bërë shumë më i arritshëm dhe udhëton me shpejtësi të pakrahasueshme se më parë?! Sidoqoftë, përgjigjja është- po. Diplomatat kanë një mori funksionesh, dhe informimi është vetëm njëri prej tyre, dhe ata sot janë pjesë e rrjetit të pakrahasueshëm të vendosjes së politikës së jashtme të çdo shteti serioz. Rëndësia e diplomacisë në botën e sotme flet mirë për buxhetet e mëdha të lëna mënjanë për nevojat e shërbimit diplomatik, por edhe për diplomacinë në përgjithësi, dhe veçanërisht për arritjen e qëllimeve të saj.

Autoritetet e marrëdhënieve ndërkombëtare të një shteti janë *kreu i shtetit*, qoftë *presidenti ose monarku, kryeministri dhe ministri i jashtëm*. Sigurisht, të gjithë ata përfaqësues diplomatikë ose konsullorë të shtetit në vendet e tjera dhe përfaqësuesit e përhershëm të tij në organizatat ndërkombëtare duhet gjithashtu të emërohen si organe të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Kreu i shtetit përfaqëson shtetin brenda dhe jashtë vendit. Brenda vendit, kreu i shtetit përfaqëson shtetin para përfaqësuesve të huaj në vend, dhe nga jashtë, kur takohet me përfaqësues të huaj jashtë vendit në takime bilaterale, konferenca shumëpalëshe, samite ose kur merr pjesë në punën e organizatave ndërkombëtare, etj.

Kreu i shtetit ka përfshirje të përshtatshme (shkalla e pjesëmarrjes varet nga legjislacioni specifik) në hartimin e politikave të jashtme në bashkëpunim me qeverinë, zakonisht duke përcaktuar udhëzimet e përgjithshme të politikës së jashtme. Në këtë drejtim, në përcaktimin e drejtimit të përgjithshëm të politikës së jashtme të një vendi, kreu i shtetit është i përfshirë në

çështje të marrëdhënieve ndërkombëtare që mund të kenë pasoja për sigurinë dhe mbrojtjen e vendit. Kjo është arsyeja pse Kushtetuta shpesh e emëron kreun e shtetit si komandant të përgjithshëm të forcave të armatosura.

Kreu i shtetit gjithashtu kryen politikën e jashtme dhe në këtë drejtim mund të udhëheqë negociatat në emër të vendit të tij dhe normalisht të përfundojë marrëveshje ndërkombëtare që janë subjekt i ratifikimit. Shtrirja e punës së Shefit të Shtetit përfshin gjithashtu të drejtën për të emëruar dhe shkarkuar ambasadorë dhe të autorizojë përfaqësues të vendit të tij jashtë vendit, për të pranuar lëshimin e një drejtuesi të misioneve diplomatike të huaja, për të marrë letrat kredenciale dhe revokuese përfaqësues diplomatikë të huaj dhe të ngjashme. Në kryerjen e këtyre detyrave, kreu i shtetit gëzon privilegje dhe imunitete të veçanta, por edhe nderime. Prandaj, kreu i shtetit nuk i nënshtrohet juridiksionit të shteteve të huaja, edhe kur ai është në një vizitë private.

Kryeministri (Kryetari i Qeverisë) kryen funksionin që nënkupton përfaqësimin e Qeverisë si organ kolektiv. Ngjashëm me kreun e shtetit, detyra e tij është që ta përfaqësojë shtetin brenda dhe jashtë vendit. Kështu, kryeministri dhe kreu i shtetit marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e politikës së jashtme. Kryeministri është i autorizuar të nënshkruajë traktate ndërkombëtare, por edhe në marrjen e vendimeve për njohjen e shteteve dhe qeverive, si dhe për krijimin e marrëdhënieve diplomatike dhe konsullore me shtetet tjera. Në varësi të legjislacionit përkatës, ai mund të emërojë, vetëm ose në konsultim me Shefin e Shtetit dhe Ministrin e Punëve të Jashtme, krerët e misioneve konsullorë të shtetit jashtë vendit. *Kryeministri* i shtetit gëzon imunitete dhe nderime në mënyrë që të jetë në gjendje të kryejë funksionet e tij.¹³

Ministri i Punëve të Jashtme është përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Jashtme të vendit të tij. Detyra e tij dhe e Ministrisë së Punëve të Jashtme në tërësi është të trajtojë çështje në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe politikës së jashtme. Kjo normalisht është brenda kompetencave të qeverisë sipas ligjit specifik kombëtar. Për aktivitetet e tij, Ministri i Punëve të Jashtme raporton dhe koordinon brenda Qeverisë me Kryeministrin, por edhe me Shefin e Shtetit për çështjet më të rëndësishme dhe drejtimet strategjike në realizimin e politikës së jashtme të vendit. Për të përmbushur funksionet e tij, Ministri gëzon imunitete dhe nderime të përshtatshme.

¹³ <https://vlada.mk/vlada-ministerstva> vizituar më: 24.02.2020

Në lidhje me të gjithë ministrinë e jashtme, mund të thuhet se zakonisht kryen punë protokollare në emër të kryeministrit dhe kreut të shtetit.¹⁴

Megjithëse secili prej këtyre organeve është pak a shumë autonom (në varësi të vendimeve legjislative në shtetin e caktuar), gjithmonë ekziston nevoja për një farë koordinimi midis tyre në sjelljen e politikës së jashtme. Megjithatë, në praktikë, kjo nuk është gjithmonë ashtu, veçanërisht në rast të kohabitacionit të dobët.

KAPITULLI II

Republika e Maqedonisë prej pavarsisë deri më sot

2.1. Pavarsia e R. Së Maqedonisë

Historia e popullit maqedonas ose historia e jetës njerëzore dhe prania në territorin e Maqedonisë, buron nga gjetja e skeleteve më të vjetër njerëzore në territorin e Maqedonisë, të vjetër 160,000 vjet. Shpikjet më të hershme të vendbanimeve të para njerëzore të organizuara në Maqedoni datojnë që nga epoka e hershme e gurit (Neolit). Organizata e parë shtetërore në territorin e rajonit të Maqedonisë është Mbretëria e Maqedonisë, e themeluar në vitin 808 para erës sonë (sipas disa burimeve, 825 para erës sonë). Mbreti i parë maqedonas ishte Karan Maqedoni, i cili përjetoj rritjen më të madhe gjatë sundimit të mbretit maqedonas Philipi II të Maqedonisë (359 - 336 para erës sonë) dhe Aleksandrit III të Maqedonisë (336 - 323 para erës sonë.) të dinastisë Argeadi.¹⁵ Me ardhjen dhe vendosjen e fiseve sllave në shekullin e gjashtë, dhe përzierjen e tyre me popullatën vendase (thrakët, ilirët, grekët e lashtë, maqedonët e lashtë, etj.), më në fund në shekullin X dhe XI formohet imazhi i popullit modern të Maqedonisë, i cili ekziston edhe sot si shumicë në territorin e Maqedonisë dhe zë pjesën më të rëndësishme të proceseve të ndryshme ekonomike, politike, demografike, historike dhe të tjera në Maqedoni.¹⁶

¹⁴ <https://mfa.gov.mk/page/21/za-ministerstvoto> vizituar më: 24.02.2020

¹⁵ Габер, В. “Од објект до субјект Македонија во меѓународните односи”, Friedrich Ebert Stiftung, Скопје, 2017, f.19-20

¹⁶ Петреска, Д, Ачкоска, В, Пешевска, М. “Историја за четврта година реформирано гимназиско образование”. Скопје. 2005, Табернакул, f.58-69

Republika e Maqedonisë shtrihet në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik, duke përfshirë 25.713 km². Kufizohet në veri me Sërbinë, në veriperëndim me Kosovën, në jug me Greqinë, në lindje me Bullgarinë dhe në perëndim me Shqipërinë. Me këtë pozicion gjeografik, Republika e Maqedonisë është një udhëkryq i rëndësishëm dhe shumë civilizime, fe dhe kultura të ndryshme kanë kaluar nëpër historinë e këtij territori.

Sipas të dhënave nga regjistrimi i fundit i vitit 2002, Maqedonia ka rreth dy milion banorë.¹⁷

Kryeqyteti i R. së Maqedonisë është Shkupi, i cili është gjithashtu qendra më e madhe politike, ekonomike, arsimore dhe kulturore.

Maqedonia është një vend kryesisht malor, me burime natyrore dhe bukuri të jashtëzakonshme. Në Maqedoni ka 34 maja malore mbi 2000 metra të larta që janë të pasura me bimësi. Malet dhe zinxhirët malorë janë ndërthurur me lugina të shumta të gjelbërta dhe fusha. Ndikimi i klimës mesdhetare dhe kontinentale siguron pjellori të lartë të tokës së punueshme, zhvillimin e blegtorisë, si dhe mundësi për zhvillimin e turizmit veror dhe dimëror. Maqedonia është gjithashtu një tokë liqenesh që përfaqësojnë pasurinë e madhe natyrore dhe potencialin kryesor të turizmit. Ekzistojnë tre liqene kryesore tektonike në jug të Maqedonisë: Liqeni i Ohrit në Ohër, Liqeni i Prespës në Prespë dhe Liqeni i Dojranit në Dojran. Këto liqene, me rrethinat e tyre natyrore dhe një numër elementesh tërheqës, janë qendra turistike të afirmuara. Në territorin e Maqedonisë ka 15 rezervuare artificiale dhe 25 liqene akullnajorë të vendosura në pjesët më të larta të masivëve malorë të formuar gjatë Epokës së Akullit. Vendpushimet dimërore, Kodra e Diellit (Popova Shapka), Bistra-Mavrovë, Krushevë, Pelister, Ponikva dhe Golak me terrene të bukura natyrore dhe pitoreske, janë vende të përshtatshme për të shijuar sportet dimërore, dhe janë ndër vendpushimet malore më të bukura.

Maqedonia ka një trashëgimi të madhe kulturore dhe historike. Për shkak të numrit të madh të vendeve arkeologjike që mbizotërojnë në kohërat e lashta, shteti me të drejtë quhet epiqendra - toka magjike e arkeologjisë. Ajo gjithashtu ka shumë manastire mesjetare dhe kisha, të cilat janë vepra të jashtëzakonshme të ndërtuesve të vjetër, piktorëve të ikonave, piktorëve të freskave dhe marangozëve, siç janë manastiret e Sh. Jovan Bigorski - Gostivar, Manastiri i

¹⁷ <http://www.stat.gov.mk/OblastOpsto.aspx?id=31> vizituar më: 27.02.2020

Markos (Markovski) - Shkup, Sh. Panteleimon - Shkup, Manastiri i Lesnovës (Leshoçki), Sh. Naum i Ohrit - Ohër; kishat: Sh. Sofje - Ohër, Sh. Spas - Shkup, Sh. Gorgia Arhangel - Kurbinovë dhe shumë manastire dhe kisha të tjera.

Perandoria Osmane gjithashtu ka lënë shenjat e saj në këtë zonë me xhami të shumta, hamame dhe bezistene si xhamia e Larme në Tetovë, Arabati baba Teqe në Tetovë, Cifte Hamam në Shkup, çarshitë e vjetra në Shkup dhe Manastir, Saat Kulla nëpër më shumë lokacione dhe shumë të tjera.

Në Maqedoni ekziston një traditë e kultivimit të folklorit maqedonas, i cili theksohet në pasurinë dhe larminë e tij, që është një shprehje e gjallë e shpirtit dhe mënyrës së jetesës së popullit maqedonas.

Stema e Republikës së Maqedonisë ka pësuar disa modifikime edhe sot e kësaj dite, qysh në vitin 1946, kur u zëvendësua stema e Republikës Popullore të Maqedonisë, dhe më 16 nëntor 2009, me heqjen e pentagramit të kuq, iu dha karakteri i saj aktual. Stema maqedonase është një nga dy peizazhet në Evropë. Stema është me karakter peizazhi. Stema e Republikës së Maqedonisë është një fushë e rrethuar nga drithëra, të cilat bashkohen në majë, e ndërthurur me pemë afioni dhe gjethe duhani, e lidhur në pjesën e poshtme nga një rrip i kryqëzuar me motive popullore. Në mes të fushës, një mal është përvijuar në rrëzë të të cilit rrjedh një lumë, dhe prapa malit është dielli që lind.¹⁸

Flamuri i Republikës së Maqedonisë është flamur zyrtar në territorin e vendit, i miratuar në vitin 1995. Nga qendra e sfondit të kuq, dielli i artë zgjerohet me tetë krahë, që shtrihet nga disku diellor dhe vazhdon deri në skajet e flamurit. Rrezet e diellit kalojnë diagonalisht, horizontalisht dhe vertikalisht. Qendra e diellit përkon me pikën ku kryqëzohen diagonalet e flamurit. Raporti i gjerësisë dhe gjatësisë së flamurit është një metër me dy metra.¹⁹

“Sot mbi Maqedoninë” është himni kombëtar i Maqedonisë, i përbërë në vitin 1941. Autori i tekstit është Vlado Maleski dhe autori i muzikës Todor Skalovski. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, ajo u miratua si himni i Republikës Socialiste të Maqedonisë në ish-

¹⁸ <http://pretsedatel.mk/republika-severna-makedonija/> (Simbolet shtetërore të Republikës së Maqedonisë) vizituar më: 24.02.2020

¹⁹ Ibid

Republikën Federale Socialiste të Jugosllavisë, dhe në vitin 1992 u shpall me ligj himni kombëtar i Republikës së Maqedonisë.²⁰

Pas vëllezërve nga Selaniku, Kirili dhe Metodi, pas perandorisë së Samuilut, u shfaq Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase në vitin 1893, e cila u konsiderua shtylla e luftës maqedonase për pavarësi. Pastaj, në vitin 1903, në formën e Republikës së Krushevës, u krijua një shtet i ri maqedonas, republika e parë në Ballkan. Lufta e Dytë Botërore ishte një mundësi e re që Maqedonia të bashkohet me të djathtën, por me kushte: Maqedonasit të njihen si komb dhe Maqedonia të njihet si shtet. Pasi mbaroi lufta, më 29 nëntor 1943 u krijua një federatë e re Jugosllave në të cilën Maqedonasit u njohën si komb më vete, dhe Maqedonia ishte anëtar i barabartë i Republikës së re Federative Popullore të Jugosllavisë.

Pas vdekjes së Josip Broz Titos, më 4 maj 1980, federata jugosllave kryesoi Presidencën e Jugosllavisë, mbajti një kryetar kolektiv të shtetit për një mandat prej një viti. I njëjti parim u zbatua në republikat dhe provincat. Në atë kohë, filloi procesi i separatizmit i filluar nga Kushtetuta e vitit 1974.

Nga 20-22 janar 1990 u mbajt kongresi i fundit i XIV i jashtëzakonshëm i SKJ (Savez Komunist Jugosllavije- lidhja komuniste jugosllave), i mbizotëruar nga pikëpamjet serbe për ruajtjen e status quo-së, dhe u refuzuan përpjekjet e komunistëve sllovenë dhe kroatë për të reformuar dhe riorganizuar SKJ-në dhe federatën. Pas përpjekjeve të pasuksesshme për të pranuar reformat, delegacioni slloven lëshon kongresin, ashtu edhe delegacionet nga Kroacia, Maqedonia dhe Bosnja dhe Hercegovina. Kështu, e vetmja parti e karakterit të përgjithshëm jugosllav - SKF - praktikisht u shpërbë në një atmosferë dramatike të zhbërjes së sistemit shtetëror njëpartiak.²¹ Në këto rrethana, mbizotëroi ideja e pluralizmit politik të partisë si shtresa kryesore e lëvizjes drejt një sistemi të demokracisë parlamentar. Klasa ka pësuar humbje, nacionalizmi po aktualizohet deri në pikën e urrejtjes dhe shovinizmit kombëtar, i cili në disa pjesë të federatës do të shkaktojë përlëshje të armatosura dhe luftime të përgjakshme.

Kundërshtimi i reformave kryesore politike dhe ekonomike ishte rritur në të gjithë vendin, duke shkaktuar tensione ndëretnike që u theksuan më së shumti në Kosovë dhe Metohi.

²⁰ Ibid

²¹ Поповски В, Ѓорѓиев В, Тодоровски З, Ачкоска В. “Создавањето на современата македонска држава”, „Македонска реч“- „Македоника литера“, Скопје 2014, f.149–154

Në mars të vitit 1989, në mes të një krize të rëndë politike dhe ekonomike, Ante Markoviç u bë kryeministër i qeverisë Jugosllave.

Miratimi i ligjeve federale në vitin 1990 lejonte formimin e lirë të partive politike nga qytetarët dhe, në kushte të caktuara ligjore, partitë u regjistruan si persona juridikë. Kjo nënkuptonte futjen e pluralizmit politik në Jugosllavi, dhe kështu n shumë parti politike u formuan në Maqedoni.

Është interesante të theksohet se në Republikën e Maqedonisë në atë kohë, në vitin 1990 kishte 26 parti politike. U krijuan kushte për mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare.

Në rrethana të tilla, duke ndryshuar dhe miratuar disa rregullore themelore, me procesin intensiv të formimit të partive dhe organizatave politike më 24 shtator 1990 - Presidenti i Kuvendit dr. Vullnet Starova njoftoi zgjedhjen e deputetëve për 11 nëntor 1990. Siç parashihej me Kushtetutë, në Kuvend, do të zgjidheshin 120 deputetë, kështu që territori i republikës ishte i ndarë në po aq zona elektorale. Në të gjitha zonat elektorale kishte nga, përafërsisht, 14000 votues. Për modelin zgjedhor zgjidhet sistemi i shumicës absolute. U garantuan liria e fjalës, bashkëdyzimit dhe informimit. Kishte një frymë konkurruese me shumë kandidatë nga alternativa të ndryshme politike, përveç kësaj, partitë politike në fazën e kandidaturave gjithashtu kishin të drejtë të propozonin kandidatë. Rregullat u përcaktuan saktësisht si kusht për zgjedhje të ndershme dhe demokratike, dhe qytetarët kishin të drejtë të propozojnë kandidatë apo përfaqësues. Zgjedhjet direkte, të lira, të barabarta dhe të fshehta, njerëzit patën mundësinë për të votuar për një prej kandidatëve. Partitë morën pjesë në mënyrë të pavarur në garën zgjedhore, në fakt nuk kishte koalicione në zgjedhje. Për shkak të papërvojës, cdokush kishte sensin e fituesit, ose për arsye të tjera, nuk u krijuan koalicione serioze me platforma të përbashkëta, kështu që të gjithë prisnin që të ishin fitues dhe të shohin veten në piedestalin fitues.²² Në këto zgjedhje morën pjesë 18 parti politike dhe 43 kandidatë të pavarur.

Në zgjedhje dhe në fushatën parazgjedhore, partitë në baza nacionale propozuan tërheqjen e Maqedonisë nga federata jugosllave dhe formimin e një shteti të pavarur dhe sovran të Maqedonisë, ushtrinë maqedonase, paratë e Maqedonisë, ekipet sportive kombëtare të

²² Андов С., “*На мој начин*”, Матица Македонска, Скопје 2003, f. 225

Maqedonisë etj. Nga ana tjetër, partitë me prapavijë komuniste mbronin fuqimisht që shteti të mbetet brenda Jugosllavisë ose të mund të formohet një federatë ose konfederatë.

Në zgjedhje, nga gjithsej 1 339 021 votues të regjistruar me të drejtë vote, në raundin e parë zgjedhor, në Listën e Votuesve ishin 1 135 728 votues ose 84.82% e numrit të përgjithshëm të votuesve të regjistruar. Në raundin e parë, zgjedhjet përfunduan në 24 zona elektorale. Në raundin e dytë të zgjedhjeve të mbajtura në 25 nëntor 1990 u votua në 96 zona tjera elektorale me pjesëmarrje 76.75%. Raund i tretë i votimit u mbajt gjithashtu më 9 dhjetor. Sipas rezultateve të zgjedhjeve, shumicën e deputetëve e fituan:

VMRO - Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (38),

SKM - Partia për Transformim Demokratik (31),

PPD - Partia për prosperitet demokratik (17),

SRSM - Unioni i Forcave Reformuese të Maqedonisë (11),

koalicioni SRSM-LSDM - Partia e Re Demokratike Progresive e Maqedonisë (6),

koalicioni PDDPNP - Partia Demokratike Popullore (5),

SPM - Partia Socialiste e Maqedonisë (4),

Partia e Jugosllavëve (2),

NDP (1),

PCER - Partia për Emancipimin e plotë të Romëve (1),

SPM-SRSM-MDSM (1)

dhe tre kandidatë të pavarur,²³ dhe menjëherë pas kësaj, në seancën konstitutive të parlamentit të ri, më 8 janar 1991, Stojan Andov u zgjodh Presidenti i parë i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.²⁴

²³ Георгиевски, С и Додевски, С, Документи за Република Македонија 1990-2005, Правен Факултет

²⁴ Шкарик С, “Македонија на сите континенти”, Унион Трејд, Скопје 2000, f. 541

Më 18 janar, zgjedhja e Presidentit të Republikës u vendos gjithashtu në axhendën e debatit parlamentar, për të cilin u emërua ose u ofrua Kiro Gligorov. Fillimisht, Kiro Gligorov nuk mori shumicën e kërkuar për dy të tretat për shkak të mungesës së mbështetjes nga partitë e VMRO-DPMNE dhe PPD. Me pak fjalë, partia do të mbështeste emërimin e Gligorov nëse një anëtar i partisë së tyre zgjidhet zëvendëskryetar dhe kryeministër i shtetit. Kështu, më 27 janar 1991, Kiro Gligorov u zgjodh Presidenti i parë i Republikës së Maqedonisë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, dhe Ljubco Georgievski nga VMRO-DPMNE u zgjodh Nënkyetar i Republikës së Maqedonisë dhe Nikolla Kljusev si Kryeministër i Qeverisë së Parë eksperte.

Dokumenti i parë shtetëror-juridik për ndarjen paqësore të Maqedonisë nga Jugosllavia ishte Deklarata e Sovranitetit dhe Pavarësisë së Republikës së Maqedonisë.

Faza e parë ishte më 25 Janar 1991, kur Asambleja e Republikës Socialiste të Maqedonisë miratoi njëzëri Deklaratën e Sovranitetit të Republikës Socialiste të Maqedonisë, me 120 vota “pro” dhe me konsensusin e plotë të të gjitha 18 partive politike në vend. Shikuar ndërkombëtarisht, Deklarata ishte shprehje politike e vullnetit të padyshimtë të popullit maqedonas për të ushtruar të drejtën e padyshimtë të padhunueshme dhe pa dallim (të përhershme) për vetëvendosje, përfshirë edhe të drejtën e shkëputjes (sukcesionit).

Faza e dytë ishte vendimi për të thirrur një referendum për pavarësinë dhe sovranitetin e Republikës së Maqedonisë, me një shumicë absolute të votave “pro”. Përfaqësuesit e koalicionit të partive shqiptare të përfaqësuara në parlament - Partia për prosperitet demokratik dhe Partia Popullore Demokratike, votuan “kundër”.

Vullneti i njerëzve u konfirmua më 18 shtator 1991 në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë me Deklaratën e Pranimit të Rezultateve të Referendumit.²⁵

Hapi tjetër i rëndësishëm për forcimin e shtetit ishte miratimi i Kushtetutës së 17 nëntorit 1991, e cila u ndryshua pas konfliktit të vitit 2001 dhe nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit. Subjekti juridik ndërkombëtar i shtetit u njoh në 8 Prill 1993 me aklamacion të Asamblesë së Përgjithshme të KB. Maqedonia pranohet si anëtare e plotë. Nga frika se mund të humbiste

²⁵ Më 8 shtator 1991 u mbajt një referendum për sovranitetin dhe pavarësinë e shtetit maqedonas. Sipas të dhënave zyrtare, nga 1.495.626 votues, 1.132.981 votuan “për” ose 71.85% të votuesve.

territoret e okupuara maqedonase, Greqia ishte e para që kundërshtoi pavarësinë e Maqedonisë. Edhe pse Bashkimi Evropian konfirmoi që Maqedonia i plotësonte kërkesat për njohje zyrtare, për shkak të kundërshtimit nga Greqia, e cila tashmë ishte anëtare e komunitetit, Komisioni Evropian vendosi të shtyjë njohjen. Greqia, e cila kishte frikë se Maqedonia mund të paraqesë kërkesa në lidhje me pretendimet historike, kulturore dhe gjuhësore në Maqedoninë e Egjeut, domethënë pjesën e okupuar të Maqedonisë nga ana e Greqisë, ka insistuar që shteti i ri nuk ka të drejtë të përdorë emrin “Maqedonia” dhe nuk ka të drejtë të përdorë stemën e Maqedonisë antike në flamurin e saj. Në korrik të vitit 1992, u zhvilluan demonstrata masive në kryeqytetin Shkup për shkak të mos arritjes së njohjes. Sidoqoftë, përkundër kundërshtimit të Greqisë, Maqedonia u pranua në Kombet e Bashkuara në vitin 1993 nën emrin e përkohshëm (emri jozyrtar) “*Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë*” (FYROM). Kjo u pasua nga vendosja e marrëdhënieve të plota diplomatike me shumë vende të Bashkimit Evropian, ndërsa Rusia, Kina, Turqia, Bullgaria dhe shumica e vendeve injoruan vërejtjet e Greqisë dhe njohën Maqedoninë nën emrin e saj kushtetues, Republika e Maqedonisë.

Në atë kohë, votuesit shqiptarë bojkotuan referendumin dhe nuk pranuan të shprehin vullnetin e tyre në mënyrë demokratike, duke besuar se ata nuk ishin të përfshirë mjaftueshëm në sistem, si dhe në të gjithë procesin.

Pas referendimit, domethënë, 17 shtator 1991, Parlamenti i Republikës së Maqedonisë konfirmoi rezultatet e referendimit, dhe 8 shtatori u shpall si dita e shpalljes së pavarësisë së Republikës së Maqedonisë, dhe ajo u shpall festë kombëtare e Maqedonisë.

2.2. Konflikti i armatosur ndëretnik në vitin 2001

Konfliktet ndodhin, inicohen ose paraqiten. Ato kanë qenë pjesë e jetës së njerëzve prej fillimit të njiut dhe vazhdojnë të ekzistojnë edhe sot e kësaj dite. Për të kuptuar konfliktin e armatosur të vitit 2001, parasëgjithash nevojitet të kuptohet se çka është konflikti, cilat janë llojet e konflikteve, cilat janë shkaqet e paraqitjes së konflikteve, burimet e konflikteve etj, duke arritur deri te zgjidhja paqësore e konflikteve.

Konflikti është një dukuri shoqërore që paraqitet së bashku me paraqitjen e shoqërisë njerëzore, në kuptimin e fjalës si mosmarrëveshje ose si zënkë në mes të dy ose më tepër personave rreth çështjeve të ndryshme jetësore. Konflikti paraqitet si ndërveprim njerëzor në çdo segment të shoqërisë nga shkaqe të ndryshme. Si dukuri shoqërore, konfliktet paraqiten në fillim të shoqërisë njerëzore si produkt i interesave dhe kundërthënive në mes të njerëzve, varësisht nga pozicionet dhe roli i tyre në organizmin shoqëror, duke filluar nga familja, fisi, e deri te grupet e organizuara dhe të strukturuar shoqërore. Varësisht nga zhvillimi historik i shoqërisë njerëzore edhe konfliktet, janë dalluar në mes vete, por gjithmonë kanë ngelur si dukuri shoqërore, të cilat zanafillën e vet e kanë nga interesat, vlerat, botëkuptimet dhe pozicionet e ndryshme të individit dhe grupeve në shoqëri. Në përgjithësi, ngelë gjithmonë si shkak i konflikteve të jenë imtësitat më të vogla, shpesh të parëndësishme. Por, ato mund të shkaktojnë konflikte me përmasa të mëdha. Si zakonisht, bazë e mirë për paraqitjen e konflikteve të ndryshme në shoqëri mund të jetë mungesa e komunikimit të ndersjellë në mes të individëve, si dhe mospërgatitja e tyre që të ballafaqohen me realitetin shoqëror. Shikuar në përgjithësi, baza e konflikteve shoqërore është përqëndruar tek marrëdhëniet shoqërore ndërnjerëzore, të cilat paraqesin një shuëllojshmëri të interesave të grupeve të ndryshme sociale.²⁶

Shkenca politike, konfliktet i trajton si dukuri shoqërore, të cilat paraqiten nën ndikim e faktorëve të ndryshëm dhe në rrethana të caktuara politike, dhe i ndanë në dy grupe; Faktorë social dhe faktorë josocial.

Faktorët social luajnë rol të rëndësishëm ndaj natyrës dhe formës së paraqitjes së konfliktit politik. Shkaqet kryesore që i determinojnë konfliktet politike mund të jenë të ndryshme, por sipas nivelit dhe bazës në të cilën përqëndrohet konfrontimi politik mund të klasifikohen në tre grupe:

1. *Format e ndryshme të marrëdhënive shoqërore* janë një ndër shkaqet dhe burimet kryesore në paraqitjen e konflikteve politike. Këto shkaqe ose burime të konflikteve i gjejmë te statusi, roli, nevoja dhe interesi i subjekteve politike për të pasur pushtet dhe pjesëmarrje në procesin e politikëbërjes. Në qeverisjen shtetërore, gjithmnë ekzistojnë kundërthënie, në mes të nevojave dhe potencialit të qytetarëve me potencialet e kufizuara të resurseve me të cilët

²⁶ Abdullahi, J, *“Politika dhe politikat publike”*, Arbëria Design 2016, Tetovë, f.127

disponojnë subjektet politike. Konfliktet politike paraqiten si shkak i lojërave politike nga palët e ndryshme në skenën politike, në veçanti nga lojërat prapaskene, ku grupet e interesit luajnë rolin e ndikimit dhe artikulimit të interesave të ngushta të oligarkëve politik. Skena politike është e ngarkuar me një pluralizëm në mes të marrëdhënieve në mes të palëve-subjekteve politike, duke manifestuar një mjedis garues dhe duke i realizuar interesat e tyre të ngushta, si zakonisht në emër të artikulimit të interesave gjithëkombëtare ose gjithëpopullore.²⁷ Ky lloj i shkaqeve të konflikteve politike ekziston gjatë tërë procesit të politikbërjes. Por, në veçanti raportet e acaruarra në mes të subjekteve politike paraqiten gjatë periudhës parazgjedhore kur lufta për pushtet zhvillohet në stilin e a.q. “makiavelian”, ku për të arritur qëllimin e marrjes dhe ruajtjen e pushtetit çdo mjet është i arsyeshëm.

2. *Ndarja ose përçarja në mes të njerëzve*, në bazë të vlerave dhe idealeve të tyre, vlerësimeve, dukurive dhe ndodhive politike aktuale janë shkak i konflikteve. Këto shkaqe të konflikteve politike paraqiten, si zakonisht në fazat e krizës dhe të lëvizjeve të mëdha shoqërore, kur paraqiten kërkesa për ndryshimin e rendit shoqëror. Gjatë historisë së zhvillimit të shoqërisë njerëzore, ndryshimet politike revolucionare, sipas K. Marksit “kanë ardhur si pasojë e kundërthënive në mes të marrëdhënieve njerëzore dhe forcave të prodhimit”. Shembuj konkret të manifestimit të këtij lloji të shkaqeve kemi pasur gjatë proceseve revolucionare, p.sh. gjatë revolucionit të lavdishëm në Angli në shek. XVII, gjatë revolucionit borgjez francez në shek. XVIII, kur kemi kundërshtimin në mes të klasës borgjeze edhe asaj feudale dhe realizimin e idealeve të mendimtarëve të asaj kohe. Ndarjet dhe përçarjet në mes të njerëzve dhe realizimi i idealeve të intelektualëve bashkëkohore si: Vatslav Haveli në Cekosllovakia, M. Gorbaçovi (si reformator me të a.q program të “Perestrojkës”) në ish- Bashkimin Sovjetik, Leh Valensa, liderit sindikal i Gdanjskit në Poloni, si dhe reformatorët tjerë bashkëkohorë që dhanë kontribut në transformimin e qetë të sistemit monoteist në një sistem pluralist. Përçarjet në Evropën Lindore në mes të njerëzve dhe idealeve të tyre u paraqitën dy shekuj më vonë, gjatë revolucionit popullor në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore më 1989, pas rrëzimit të murit të Berlinit që simbolizonte bashkimin jo vetëm të dy Gjermanive, por edhe të Evropës, në frymën e Shumanit dhe Konrad Adenauerit, arkitektëve të UE dhe të shoqërisë qytetare bashkëkohore.²⁸

²⁷ Ibid, f.131

²⁸ Ibid, f.131

3. Si burim i tretëi konflikteve në suaza të shkencës politike njihet *procesi i identifikimit të qytetarëve (identiteti)*, si antar i grupit etnik, social, religjioz ose i ndonjë grupi tjetër shoqëror. Identiteti si një karakteristikë themelore e çdo grupi shoqëror paraqet një tërësi vlerash, nëpërmjet të cilave dallohen grupet shoqërore dhe individët në mes vete në suaza të grupit ose në mes të grupeve të ndryshme në shoqëri. Si një shembull tipik, mund të merret R. E Maqedonisë, e cila ka konteste: me Sërbinë- në lidhje me identitetin religjioz, me Bullgarinë- kontesti me gjuhën dhe kulminacioni-kontestimi i identitetit shtetëror me Greqinë në lidhje me emrin e shtetit të Maqedonisë. Këto elemente janë burimi i konfliktit permanent që ka Maqedonia ,e fqinjët e saj, por edhe problemi rref integritit të vendit në strukturat euroatlantike.

Sipas palëve dhe objektit të konfliktit kemi këto lloje të konflikteve:

- a) Konflikte politike*
- b) Konflikte fetare*
- c) Konflikte ekonomike*
- d) Konflikte nacionale*
- e) Konflikte racore etj.*

Në këtë rast, do të përqëndrohemi vetëm te konfliktet politike të cilat paraqiten si rezultat i kontesteve të ndryshme në procesin dhe format e ndryshme të qeverisjes shtetërore. Konfliktet politike, si zakonisht paraqiten në dhe rreth pushtetit, në mes aktorëve institucional dhe jashtëinstitucional, në marrjen dhe menaxhimin e pushtetit shtetëror.

Tipologjia e konflikteve politike, realizohet në bazë të disa burimeve dhe shkaqeve konkrete. Vrësisht nga kriteret e ndryshme, paraqiten këto lloje të konflikteve politike:

- sipas vendit dhe lëmit në të cilën paraqiten konfliktet (të jashtme dhe të brendshme)*
- sipas nivelit dhe karakterit të regullativës së tyre (të institucionalizuara dhe jo të institucionalizuara)*
- sipas karakteristikave të tyre cilësore (antagoniste dhe joantagoniste)*

- sipas nivelit publik të konkurrencës së palëve (të hapur dhe të mbyllur)
- sipas karakteristikave kohore të palëve konkurruese (afatshkurte dhe afatgjate)
- sipas strukturës dhe organizimit të regjimit administrativ (në bazë vertikale dhe horizontale).

Ekzistojnë edhe klasifikime tjera të konflikteve varësisht nga studjuesit dhe autorët e ndryshëm që mirren me studimin e kësaj dukurie.²⁹

Varësisht nga mjedisi dhe rrethi në të cilën zhvillohen konfliktet mund të kemi paraqitjen e konflikteve lokale ose shtetërore dhe ndërkombëtare. Gjatë trajtimit shkencorë të konfliktit, gjithmonë do të duhet që të kemi parasysh fazat nëpërmjet të cilave manifestohet konflikti si një dukuri shumëdimensionale. Ndarja e këtyre fazave nëpërmjet të cilave kalon konflikti, mund të bëhet, sipas sjelljes së pjesëmarrësve dhe pasojave ndaj pjesëmarrësve dhe të tjerëve në rrethin ku zhvillohet konflikti. Cdo konflikt kalon nëpër këto faza:

1. *Faza e lindjes së konfliktit*, paraqet zansafillën e procesit të konfliktit, duke u manifestuar me një përplasje publike të interesave të palëve në konflikt. Kjo përplasje si zakonisht manifestohet me keqësimin e marrëdhënieve të palëve në konflikt, me një tendencë të acarimit të këtyre marrëdhënieve. Në praktikë, kjo, mund të manifestohet ndryshe, nga rasti në rast, duke filluar me ftohjen e marrëdhënieve, tensionimin e gjendjes e deri te ndërprerja e menjëhershme e komunikimit të ndërsjellë në mes të palëve gjegjëse.

2. *Faza e zhvillimit të konfliktit*, manifestohet ndryshe, varësisht nga lloji i konfliktit, edhe pse si zakonisht në këtë fazë vijnë në shprehje veprimet e palëve në konflikt, duke i shpalosur publikisht interesat e tyre dhe pikat kontestuese në mes vete. Në këtë fazë të konfliktit identifikohen motivet dhe qëndrimet e palëve në konflikt, me çka mund të parashihet zhvillimi i mëtejshëm dhe mënyrat e zgjidhjes së konfliktit.

3. *Faza e zgjidhjes së konfliktit*, është një ndër fazat më të rëndësishme në tërë procesin e menaxhimit të konflikteve. Në këtë fazë, medoemos do të duhet vlerësuar, momentin dhe mënyrën adekuate të intervenimit në zgjidhjen e konfliktit. Trajtimi shkencor i konfliktit, dmth,

²⁹ Ibid, f.132

realizimi- bërja e një analize të mirëfilltë cilësore dhe sasiore të fakteve dhe dëshmive të dy fazave të mëparshme, të lindjes dhe të zhvillimit të konfliktit. Kjo analizë do të na shërbente në marrjen e hapave të mëtutjeshëm, që do të thotë se në momentin më të përshtatshëm të inicohen bisedimet si një ndër menyrat elementare në zgjidhjen e çdo konflikti. Varësisht se si është zhvilluar konflikti dhe në çfarë gjendje- niveli ndodhet kontesti në fjalë, ekzistojnë tri formamënyra të zgjidhjes së konfliktit:

1. *Bisedimet*, janë forma më e preferuar për trajtimin e çdo kontesti shoqëror, pa marrë parasysh rrethanat dhe palët më konflikt. Cdo zgjidhje e konfliktit do të duhet të fillohet me bisedimet e drejtpërdrejta nga palët e konfrontuara, duke krijuar ambient për mirëkuptim dhe tolerancë reciproke. Bisedimet janë formë e shkëmbimit të fjalëve në mes palëve në konflikt, duke shprehur bindjet, qëndrimet, interesat dhe pozicionet e ndryshme rreth çështjeve kontestuese. Bisedimet mund të fillojnë dhe të zhvillohen nëse ekziston, ose krijohet një atmosferë-klimë e respektit të ndërsjellë dhe interesit të përbashkët. Bisedimet si zakonisht zhvillohen në mes të palëve në konflikt me qëllim të arritjes së një pajtueshmërie rreth çështjeve kontestuese, para shpërthimit të konfliktit dhe gjatë zhvillimit të konfliktit.³⁰

2. *Ndërmjetësimi ose negociatat*, janë formë e zgjidhjes së konflikteve nëpërmjet të inkuadrimit të palës së tretë. Ky proces zhvillohet në të shumtën e rasteve kur dështojnë bisedimet në mes të palëve në konflikt, ose në situata të acarimit të konfliktit në përmasa shumë të mëdha, kur mbyllet çdo hapësirë që të zhvillohen bisedimet direkte në mes të palëve në konflikt.

3. *Arbitrazhi*, është formë e zgjidhjes së kontesteve të ndryshme në mes të palëve në konflikt nëpërmjet të palës së tretë, por si zakonisht nga pozicioni institucional, që do të thotë se nuk lejohet debat në mes të palëve në konflikt, por vetëm nxjerrje të dëshmive si fakte mbrojtëse nga palët në procesin e gjyqimit. Arbitrazhi si proces realizohet nga institucionet lokale ose ndërkombëtare, varësisht nga lloji dhe karakteri i konfliktit. Kontestet e ndryshme si në nivel shtetëror ashtu edhe në nivel ndërkombëtar zgjidhen nëpërmjet organeve gjyqësore ose

³⁰ Ibid, f.133

nëpërmjet të organeve special të formuara, siç është gjykata ndërkombëtare për krime lufte në ish Jugosllavi në Hagë.³¹

Shqiptarët janë pakica më e madhe etnike në Republikën e Maqedonisë. Ata janë kryesisht të banuar në Maqedoninë veriperëndimore afër kufijve të Shqipërisë dhe Kosovës. Shqiptarët në Maqedoni, megjithë ankesat e vazhdueshme për trajtimin e tyre si “qytetarë të klasit të dytë” në sistemin politik pas pavarësisë, kanë luajtur rol të rëndësishëm në marrëdhëniet ndëretnike dhe në politikën nacionale. Në vitin 1990, populli shqiptarë në Republikën e Maqedonisë formuan parti politike që janë përfshirë në të gjithë qeveritë maqedonase postkomuniste. Njëzet e pesë shqiptarë (dy parti shqiptare), një rom nga Partia e Romëve në Maqedoni, dhe disa Sërbë, turq dhe vllah, fituan vendet në zgjedhjet parlamentare të vitit 1998.³²

Shumica e komuniteteve shqiptare janë të përqendruara në zonat përreth Tetovës (rreth 70%), Gostivar (66%), Dibër (58%), Strugë (56%), Kërçovë (31%), Kumanovë (25%) dhe Shkup (20%). Numri i popullsisë shqiptare në Republikën e Maqedonisë, që nga viti 1948, vazhdon të rritet. Sipas të dhënave zyrtare, shqiptarët në Maqedoni në vitin 1953 ishin 10%, në 1971 17%, në 1991 21%.³³

Si rezultat i nevojës për të mbështetur qëllimet e tyre politike disa shqiptarë pretendojnë se rreth 30% e popullatës që jetojnë në Maqedoni, janë shqiptarë, dhe nga ana tjetër, për të njëjtat arsye, disa maqedonas gjithashtu pretendojnë se përfaqësimi i këtij komuniteti etnik është dukshëm më i ulët dhe është nën 20% të popullsisë së përgjithshme.³⁴

Për dallim nga të gjitha shtetet e ish-Jugosllavisë, Republika e Maqedonisë fitoi pavarësinë e saj pa konflikte ushtarake dhe gjakderdhje. Pas rënies së të ashtuquajturës qeveria e parë eksperte e Republikës së Maqedonisë, pushteti u mor nga Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM). Qeveria e vitit 1992 përfshiu Partinë për prosperitet demokratik (PPD) dhe mbeti deri në rënien e pushtetit më 1998. Universiteti i parë shqiptar në Republikën e Maqedonisë u hap në vitin 1994, (Universiteti i Tetovës, tash Universiteti Shtetëror i Tetovës) i

³¹ Ibid, f.134

³² Ortakovski, V, “*Interethnic relations and minorities in the Republic of Macedonia*”, St. Cyril and Methodius University, Skopje f.24-25 (<http://www.seep.ceu.hu/issue21/ortakovski.pdf>)

³³ http://www.stat.gov.mk/pdf/kniga_13.pdf vizituar më: 25.02.2020

³⁴ <http://star.vecer.com.mk/tekst.asp?tid=8988> vizituar më: 12.08.2018

cili si universitet shtetëror mbetet i panjohur nga autoritetet deri në janar të vitit 2004. Problemet kryesore me të cilat përballë LSDM-ja ishin privatizimi, papunësia dhe niveli i lartë i korrupsionit. Për më tepër, në zgjedhjet parlamentare të vitit 1998, pushteti u mor nga opozita e atëhershme e udhëhequr nga VMRO-DPMNE.³⁵

Partia Demokratike e Shqiptarëve u bashkua me qeverinë e vitit 1998. Qeveria e re në Maqedoni u përball me probleme dhe sfida të mëdha, dhe së shpejti filloi të humbasë besimin tek elektorati. Në nëntor të vitit 2000, Alternativa Demokratike doli nga koalicioni qeverisës dhe partner i ri i koalicionit të VMRO-DPMNE u bë Partia Liberale e Maqedonisë. Skandalet politike dhe rëniet ekonomike kanë pasur ndikim të madh negativ në qeveri.

Më 9 korrik 1997, në Gostivar dhe Tetovë u zhvilluan ngjarjet e “9Korrikut”. Ato ishin një nga ngjarjet më të mëdha dhe më të rëndësishme në vend, pra në historinë e fundit të Maqedonisë. Përkatësisht, pas miratimit të ndarjes së re territoriale në vitin 1996, kryetarët e PDSH-së, Rufi Osmani dhe Alajdin Demiri, fituan zgjedhjet lokale të vitit 1996. Revolta midis popullatës maqedonase do të nxitej nga shfaqja e flamurit kombëtar shqiptar përpara ndërtesave komunale. Kështu, Kryeministri i atëhershëm Branko Cërvenkovski vendosi të zhvillojë një aksion policor për heqjen e flamujve.

Bastisjet e policisë maqedonase në qytetin e Gostivarit filluan më 8 korrik të vitit 1997, duke bastisur në disa bare nate. Të nesërmen, më 9 korrik të vitit 1997, në Gostivar, shqiptarët etnikë protestuan me valëvitjen e flamujve shqiptarë dhe turk. Në mes të turmës ishte kryetari i atëhershëm Rufi Osmani. Në të njëjtën ditë, filloi aksioni për heqjen e flamujve. Kur protestuesit u afruan forcave të sigurisë maqedonase, u hap shpërthim zjarri mbi ta me koktej të molotovit. Policia u përgjigj me kundërsulm, duke vrarë katër civilë etnikë shqiptarë. U plagosën me qindra shqiptarë dhe u malltretuan me rrahje me mijëra tjerë. Në fund të ditës, policia maqedonase hyri në kuvendin komunal, duke ulur flamurin shqiptar, dhe dy kryetarët e komunave u arrestuan.

³⁵ <https://www.sobranie.mk/posleden-sostav-1991-1994.nspix>, <https://www.sobranie.mk/posleden-sostav-1994-1998.nspix>, <https://www.sobranie.mk/posleden-sostav-ad8de3d5-d6b3-43b2-8ad9-9bf4a9ca95ec.nspix> vizituar më: 11.02.2020

Rufi Osmani u dënua me trembëdhjetë vjet burg, por pas ndryshimit të qeverisë në vitin 1998, ai u amnestua. Alajdin Demiri u dënua me dy vjet burg, por edhe ai u amnestua pas vitit 1998.³⁶

Maqedonasit e interpretuan këtë ngjarje si funksionim të shtetit të së drejtës, ndërsa shqiptarët i shfrytëzuan ngjarjet si një argument për publikun botëror se qeveria shkelte të drejtat e tyre të njeriut dhe se ata ishin të privuar dhe të diskriminuar. Sot, ne shqiptarët në Republikën e Maqedonisë e shënojmë këtë ditë më 9 korrik si datë e cila do të mbahet mend për fillimin e ecurisë së proceseve të mëtutjeshme sa u përket të drejtave dhe barabarësive.

Në vitin 1999, shpërthyen trazirat në Kosovë midis shqiptarëve etnikë dhe sërbeve.³⁷ Në të njëjtën kohë, zgjedhjet presidenciale të Maqedonisë vetëm përkeqësuan tensionet ndëretnike midis shqiptarëve dhe maqedonasve. Tensionet u intensifikuan kur Republika e Maqedonisë u “përmbyt” nga 344,000 shqiptarë etnikë, refugjatë nga lufta e Kosovës.³⁸

Pas kësaj, në Maqedoni u zhvillua një rrjet edhe më i madh i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ose UCK-së.

Në mënyrë të ngjashme, në Maqedoni, u shfaq një “organizatë e re” e njohur si Ushtria Çlirimtare Kombëtare ose UCK. UCK do të ishte vazhdim dhe transformim i qëllimeve të UCK (Kosovës) në territorin e Republikës së Maqedonisë, dhe anëtarët e saj ishin ish-pjesëtarë të UCK-së (Kosovës) që morën pjesë në luftimet në Kosovë por edhe duke u bashkangjitur edhe djemt tanë. Me shpërbërjen e UCPMB, shumica e tyre u zhvendosën në territorin e Maqedonisë, gjithashtu brenda radhëve të UCK-së. Sipas disa të dhënave, selia e UCK-së ishte në Prizren, dhe drejtohej nga Emrush Xhemali, Ali Ahmeti (përfaqësues politik), Fazli Veliu i cili ishte në krye të diasporës dhe Gzim Ostreni i cili ishte komandant i përgjithshëm dhe ish anëtar i Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Organizata mori mbështetje të madhe nga Kosova, Shqipëria, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Diaspora shqiptare në vendet e Evropës Perëndimore dhe Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Financimi i UCK-së ishte përmes të ashtuquajturit vetëfinancim,

³⁶ Rexhepi, Z, “Zhvillimet politiko-shoqërore të shqiptarët në Maqedoni 1990 – 2001” Tringa Design, Tetovë 2005, f.125

³⁷ <http://www.hrw.org/campaigns/kosovo98/timeline.shtml> vizituar më 16.02.2020

³⁸ Astri Suhrke, Michael Barutciski, Peta Sandison, Rick Garlock, UNITED NATIONS HIGH COMMISSIONER FOR REFUGEES EVALUATION AND POLICY ANALYSIS UNIT, “The Kosovo refugee crisis”, 2000, f.6 (<https://www.unhcr.org/3ba0bbeb4.pdf> vizituar më: 11.02.2020)

financim nga njerëzit lokalë, shfrytëzimi i fondeve të ish UCK-së (Kosovës). Emigracioni shqiptar në Zvicër konsiderohej qendra e financimit të organizatës.³⁹

Veprimet e para të shqiptarëve etnikë në Maqedoni u zhvilluan në fund të vitit 2000 dhe në fillim të vitit 2001, kryesisht përgjatë vijës së kufirit të Maqedonisë me krahinën autonome Sërbe (shteti i sotëm) Kosovën. Në fillim të luftës, UCK shpesh u bënte thirrje popullatës maqedonase në Maqedoninë veriperëndimore të lëshonin shtëpitë e tyre. Në fillim të krizës, autoritetet maqedonase nuk morën ndonjë masë serioze sepse ishin të bindur që veprime të tilla nuk ishin të drejtuara kundër Maqedonisë. Por pas gati dy muajsh, situata doli jashtë kontrollit dhe autoritetet maqedonase më në fund filluan përgatitjet për luftë. Nga ana tjetër, përfaqësuesit shqiptarë pretendonin se Republika e Maqedonisë ishte e gatshme për këtë luftë.

Në Janar të vitit 2001, Ushtria Clirimtare Kombëtare thirri dhe konfirmoi përgjegjësinë për sulme të përsëritura kundër policisë maqedonase. Drejtuesit e UCK-së Ali Ahmeti dhe daja i tij, Fazli Veliu, të cilët vijnë nga Kërçova, thanë se ata kishin mijëra ushtarë të gatshëm për të luftuar policinë dhe ushtrinë maqedonase. Autoritetet maqedonase thonin se “rebelët” e UCK-së vijnë kryesisht nga Kosova, që është një burim kryesor agresioni, dhe shqiptarët etnikë në Maqedoni.

Në atë vit 2001, tani të largët, drejtuesit e koalicionit qeverisës të atëhershëm VMRO-DPMNE-PDSH (Ljupco Georgievski dhe Arben Xhaferi) argumentuan se marrëdhëniet ndëretnike kurrë nuk ishin më të relaksuara, por ja që na ndodhi ai konflikt i armatosur. Kështu që sot, pas një distance kohore kaq të gjatë, nuk është plotësisht e qartë se çfarë në të vërtetë ndodhi atëherë. Pavarësisht nëse ishte një luftë për të drejtat, për territoret, për pushtet, për kontrollin e krimit të organizuar etj, dhe pas kaq shumë dëshmime, librave, artikujve të lajmeve dhe analizave, kjo pyetje mbeti ende pa përgjigje. Sipas analizave dhe pikëpamjeve të shumicës së analistëve maqedonas, bëhet fjalë për një operacion kriminal-ushtarak që më vonë bëhet një “luftë për të drejtat” kryesisht nën ndikimin e bashkësisë ndërkombëtare, ndërsa nga ana tjetër, shumica e analistëve dhe studiuesve shqiptarë thonë se bëhet fjalë vetëm për përmirësimin e statusit të pakicës shqiptare në Maqedoni, pra për të drejtat dhe liritë e tyre.

³⁹ Rexhepi, Z, “Zhvillimet politiko-shoqërore të shqiptarët në Maqedoni 1990 – 2001” Tringa Design, Tetovë 2005, f.182-190

Gjatë kohës së koalicionit VMRO-PDSH lideri i saj Arbën Xhaferi disa herë u pat bërë thirrje partnerëve të koalicionit qeveritar se është i domosdoshëm një dialog maqedono-shqiptar për të ndërtuar një shtet multietnik demokratik mbi baza të barazisë politike, ekonomike, sociale e kulturore midis popujve. Edhe kryetari i atëhershëm i Kuvendit të Maqedonisë Dr- Savo Klimovski (një nacionalist i rregjitur) dhe kryetari i Alternativës Demokratike Vasil Tupurkovski e përqaftuan këtë ide dhe kishte gjasa të mëdha ato të fillojnë sikur konflikti të mos kishte plasur pa asnjë konsulte ndërshqiptare.⁴⁰

Për shembull, lideri i atëhershëm i PDSH-së, Arben Xhaferi, deklaroi që në fillimin e konfliktit se ishte një konflikt shqiptaro-shqiptar dhe se maqedonasit nuk duhet të ndërhyjnë fare. Kjo deklaratë mbështetet nga fakti se “territoret e çliruara”, d.m.th., vendbanimet që ishin nën kontrollin e UCK-së, ishin në të vërtetë territore shqiptare, ku maqedonasit ishin praktikisht inekzistentë, madje edhe përmes rendit publik dhe shërbimeve tjera. Nga ana tjetër, deklaratat e para të UCK-së (të ashtuquajturat “komunikata”) ishin të mbushura me mesazhe nacionaliste, shoviniste, madje dhe raciste për të pastruar “territoret shqiptare” të të gjithë elementëve “sllavo-maqedonas”

Fakt është se ishte fundi i luftërave jugosllave, fundi i së cilës ishte marrëveshja e Kumanovës e vitit 1999, me të cilën praktikisht Kosova fitoi pavarësinë.⁴¹ Gjithashtu një fakt tjetër është që kufiri Kosovë-Maqedoni ishte i pa shënuar dhe si i tillë ishte shumë i favorshëm për zhvillimin e krimit të organizuar, kontrabandës së armëve, drogës, etj. Një nga vorbullat e luftës Jugosllave ishte një strukturë gjysmë kriminale, që mbetën të pa shpërblyer si veteranë, me disa analistë që argumentojnë se përplasja ka të bëjë me marrjen e kontrollit politik mbi territoret me popullsi kryesisht shqiptare. Kjo tezë konfirmohet nga mbizotërimi politik i BDI-së, partisë politike që erdhi direkt nga UCK-ja, për pothuajse të gjithë periudhën që nga përfundimi i konfliktit e deri më sot. Është interesante të theksohet se në nëntë vitet e fundit që nga koha kur VMRO-DPMNE ka qenë në pushtet, dhe në një masë më të vogël që kur BDI është përfaqësuese në Qeveri, edhe pse një seri incidentesh shumë të rënda që kanë shkaktuar tensione shqetësuese ndëretnike (vrasja e rëndë të liqeni i Smilkovës, vrasja në Gjorçe Petrov, vrasja në Gostivar,

⁴⁰ Muhamed HALILI, “Dëshmi/Si lindi Marrëveshja kornizë”, 24/08/2018, <https://nezavisen.mk/deshmisi-lindi-marreveshja-kornize/?lang=sq> vizituar më: 05.03.2020

⁴¹ <https://www.koha.net/arberi/167611/20-vjet-nga-marreveshja-e-kumanoves-kapitullimi-i-millosheviqit/> vizituar më: 21.02.2020

ngjarjet e Kalasë së Shkupit, ngritja e monumentit të Car Dushanit dhe prishja e saj e dhunshme, protesta për çështjen “Monstra”, përleshje ndëretnike midis grupeve tifoze, dhe incidentet në autobusët e qytetit në Shkup, maskat fyese në Karnevalin e Vevçanit), zyrtarë të lartë të partive qeverisëse, pothuajse si një kor, deklarorin se marrëdhëniet ndëretnike ishin relaksuese dhe asnjëherë më mirë.

Për më tepër, është i qartë fakti që popullsia shqiptare në Maqedoni është ndjerë e majorizuar pothuajse në të gjitha nivelet: në nivelin politik për shkak të mbivotimit të rregullt në parlament, në nivelin shoqëror për shkak të privimit të të drejtave të fituara me Kushtetutën e vitit 1991,⁴² në raport me Kushtetutën e vitit 1974,⁴³ niveli arsimor, niveli kulturor etj. Për këtë qëllim, Rufi Osmani shkruan një artikull me titull “Republika e Maqedonisë, paqja e paqartë - sfidat dhe alternativa për stabilizimin dhe integrimin”, të cilën e boton në gusht 2002 në gazetën “Zëri”. Ai thotë se kryengritja e armatosur shqiptare në Maqedoni ishte pasojë e një dekade refuzimi të vazhdueshëm dhe të përhershëm të kërkesave politike shqiptare nga institucionet shtetërore të kontrolluara nga shumica sllavo-maqedonase, e ndjekur nga një përdorim i vazhdueshëm i dhunës kundër popullatës civile shqiptare. Pavarësisht nga fakti që në dekadën e kaluar ka pasur një përfaqësim multi-etnik në nivelin parlamentar dhe qeveritar, në të gjitha nivelet e sistemit është ruajtur diskriminimi total ndaj popujve jo-sllavë në të gjitha nivelet e institucioneve, të trashëguara nga sistemi komunist, së bashku me mosnjohjen dhe shkurtimin permanent të të drejtave gjuhësore dhe kulturore të jo-sllavëve brenda institucioneve të sistemit. Për ta thënë qartë dhe shkurt, erozioni i menaxhmentit politik të shtetit në fushën e reformës etnike ka rezultuar si bumerang, një luftë të brendshme, më saktë, në kryengritjen e armatosur shqiptare.⁴⁴

Për dallim nga Osmani, për gazetarin dhe publicistin Saso Ordanovski, konflikti i vitit 2001 duhet të shihet si kontekst rajonal. Sipas tij, bëhet fjalë për situata klasike post-konfliktuale, në të cilat rregullisht mbesin struktura dhe formacione të caktuara, të cilat nuk mund të socializohen ose të paktën nuk mund ta bëjnë atë menjëherë. Sipas Ordanovskit, mund të pritej që konfliktet jugosllave, e në veçanti konflikti sërbo-shqiptar, të shtrihet në Maqedoni,

⁴² <https://www.sobranie.mk/content/Odluki%20USTAV/UstavSRSM.pdf> vizituar më: 27.02.2020

⁴³ <http://www.slvesnik.com.mk/Issues/0AF2E0456C964935B7705FB5BF6F31F9.pdf> vizituar më: 27.02.2020

⁴⁴ <http://www.globusmagazin.com.mk/?ItemID=D72ED9AE7AC05748872862B8D78DA0EC> (Revista javore Globus, nr.414 07.04.2015) vizituar më: 02.03.2020

por çështja ishte se si shteti do të arrinte ta menaxhojë atë, d.m.th. a do ta mbante konfliktin në incidente kufitare ose do ta lejonte atë të përshkallëzohet dhe të eskalojë në vend. Fatkeqësisht, sipas gazetarit, shteti maqedonas nuk arriti të merrej me këtë çështje, dhe më vonë një numër i popullsisë vendase iu bashkua këtyre strukturave dhe e gjitha kaloi ashtu si kaloi.⁴⁵

Në të njëjtën mënyrë është edhe mendimi i profesor Ljubomir Frçkovski. Frçkovski i tha një prej mediave se ishte pothuajse e qartë se nuk do të kishte luftë nëse Maqedonia nuk do ta kishte Kosovën si fqinj. Sipas profesorit, lufta nuk ka asnjë lidhje me të drejtat e shqiptarëve në Kushtetutën e vitit 1991. Ai vëren se në atë kohë, kishte komplimente se si kushtetuta trajton të drejtat e pakicave, e cila në këtë kuptim vlerësohej si më e mira në të gjithë rajonin. Sipas asaj logjike, më së pakti do të mund të kishte ndodhur konflikti në Maqedoni, që do të ishte shkak për represion të të drejtave të pakicave. Ky është një mendim jokorrekt dhe i pasaktë, sipas Frçkovskit. Disa liberalë po përdorin tezën se nëse Kushtetuta do të na jepte më shumë të drejta, lufta mund të shmangeshte. Frçkovski, megjithatë, është kategorik, duke thënë se konflikti, pas operacionit të Kosovës dhe çlirimit të UCK-së, ishte pothuajse i pashmangshëm, që do të thotë se mund të ishte trajtuar ndryshe, duke u zvogëluar, reduktuar në incidente kufitare nëse udhëheqësia e shteti do të ishte pak më e aftë. Por ai vlerëson se konflikti ishte i pashmangshëm.⁴⁶

Konflikti ushtarak në Republikën e Maqedonisë nga viti 2001 zgjati nga janari deri në nëntor të vitit 2001. Konflikti filloi kur formimi paramilitar shqiptar i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (shkurt UCK) sulmoi forcat maqedonase të sigurisë. Vazhdoi gjatë vitit 2001 dhe përfundoi me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit në gusht të po këtij viti, e cila do të diskutohet më tej.

⁴⁵ <http://www.globusmagazin.com.mk/?ItemID=D72ED9AE7AC05748872862B8D78DA0EC> (Revista javore Globus, nr.414 07.04.2015) vizituar më: 02.03.2020

⁴⁶ <http://www.globusmagazin.com.mk/?ItemID=D72ED9AE7AC05748872862B8D78DA0EC> (Revista javore Globus nr.414 07.04.2015) vizituar më: 02.03.2020

2.3. Marrëveshja kornizë e Ohrit si zgjidhje e konfliktit të armatosur ndëretnik

Marrëveshja Kornizë e Ohrit (MO) u nënshkrua në 13 gusht të vitit 2001. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje ishte një përgjigje ndaj konfliktit të armatosur që ndodhi në Republikën e Maqedonisë atë vit, midis forcave të sigurisë maqedonase dhe forcave të armatosura të UCK-së (Ushtria Clirimtare Kombëtare). Megjithëse u nënshkrua zyrtarisht në Shkup, marrëveshja u quajt “e Ohrit” sepse nënshkrimi u parapri nga një seri bisedimesh, shumica e të cilave u zhvilluan në qytetin e Ohrit afër kufirit shqiptar. Nënshkruesit e MO ishin udhëheqësit e katër partive më të mëdha politike të atëhershme në Republikën e Maqedonisë (dy partitë më të mëdha etnike maqedonase dhe dy partitë më të mëdha etnike shqiptare), Presidenti i Republikës së Maqedonisë dhe nga një i dërguar special i SHBA-së dhe BE-së. Kjo është arsyeja pse kjo marrëveshje është gjithashtu një marrëveshje paqeje e garantuar nga faktori ndërkombëtar. MO ishte baza për një sistem të ri të ndarjes së pushtetit dhe ristrukturimit të brendshëm të Maqedonisë, kryesisht përmes ndryshimeve kushtetuese, miratimit të ligjeve të reja dhe rishikimit të ligjeve të vjetra.

Marrëveshja Kornizë e Ohrit përmban dhjetë pika dhe tre anekse. Pika e parë titullohet “*Parimet Themelore*” dhe përbëhet nga pesë nën-pika; pika dy quhet “*Ndërprerja e armiqësive*”, që përbëhet nga vetëm një nën-pikë; pika tre ka titullin “*Zhvillimi i një qeverie të decentralizuar*”, e përbërë nga tri pika; pika katër – “*Mosdiskriminimi dhe përfaqësimi i drejtë*”, i përbërë nga tri nën-pika; pika pesë – “*Procedurat speciale parlamentare*”, që përbëhen nga dy nën-pika; pika gjashtë – “*Edukimi dhe përdorimi i gjuhëve*”, ka tetë nën-pika; pika shtatë – “*Shprehja e identitetit*”, që përfshin vetëm një nën-pikë; pika tetë – “*Zbatimi*”, i përbërë nga tri nën-pika; pika nëntë ka të bëjë me Anekset dhe përmban Shtojcat A, B dhe C, të cilat konsiderohen pjesë përbërëse e Marrëveshjes. Shtojca A ka titullin “*Amandamentet Kushtetuese*”; Shtojca B – “*Ndryshimet legjislativë*” dhe Shtojca C – “*Implementimi dhe masat e zbatimit dhe krijimit të besimit te ndersjellë*”. Pika e fundit, pika dhjetë, përmban “*dispozitat përmblylëse të kontratës*”.⁴⁷

Marrëveshja Kornizë e Ohrit fillon me sa vijon: “Pikat në tekstin e mëtejshme ofrojnë një kornizë të harmonizuar për të siguruar të ardhmen e demokracisë në Maqedoni dhe për

⁴⁷ <https://www.bdi.mk/documents/MARREVESHJA-E-OHRIT.pdf> vizituar më: 03.03.2020

lehtësimin e zhvillimit të marrëdhënieve më të ngushta dhe më të integruara midis Republikës së Maqedonisë dhe komunitetit Euro-Atlantik. Kjo Marrëveshje Kornizë do të promovojë zhvillimin paqësor dhe harmonik të shoqërisë civile, duke respektuar identitetin etnik dhe interesat e të gjithë qytetarëve të Maqedonisë”.

Parimi i parë themelor është paraqitur në nën-seksionin e parë të MO: “Përdorimi i dhunës për të arritur qëllimet politike është refuzuar plotësisht dhe pa kushte. Vetëm zgjidhjet paqësore politike mund të garantojnë të ardhmen e qëndrueshme dhe demokratike të Maqedonisë”. Nisur nga rrethanat në të cilat është lidhur kontrata, një fillim i tillë i MO është i qartë. Qëllimi i kësaj ishte dekurajimi i dhunës ekzistuese.

Në nën-pikën e dytë të MO thuhet: “Sovraniteti dhe tërësia territoriale e Maqedonisë dhe karakteri unitar i shtetit janë të paprekshëm dhe duhet të ruhen. Nuk ka zgjidhje territoriale për çështjet etnike”.

Në nën-seksionin e tretë të MO thuhet: “Karakterit multietnik i shoqërisë maqedonase duhet të ruhet dhe të pasqyrohet në jetën publike”.⁴⁸ E vërteta është se karakteri multietnik i Republikës së Maqedonisë është i padiskutueshëm, mirëpo MO u nënshkruajt me qëllim të ecjes përpara të proceseve tjera që kishin të bëjnë me ngecjet e çështjeve të avansimit të përdorimit të gjuhëve, decentralizimin, avansimin e arsimit sipëror etj.

Nënseksioni i katërt i MO i Parimeve Themelore thotë se “Një shtet modern demokratik, në rrjedhën natyrore të zhvillimit dhe pjekurisë së tij, duhet të sigurojë vazhdimisht që Kushtetuta të plotësojë në tërësi nevojat e të gjithë qytetarëve në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare, të cilat ata edhe vetë vazhdimisht janë duke evoluar”.⁴⁹

“Ndërpreja e armiqësive” është titulli i pikës së dytë të MO. Vetë titulli shpjegon rrethanat në të cilat u zhvilluan negociatat dhe nënshkrimi i MO. Përfundimi i konfliktit të mëtejshëm të armatosur ishte arsyeja kryesore për përfundimin e kësaj Marrëveshjeje. Nënshkrimi i MO përfundoi konfliktin. Prandaj, edhe pse është një marrëveshje për ristrukturimin

⁴⁸ <http://javno.mk/shto-pishuva-vo-ramkovniot-dogovor-od-2001-godina/> vizituar më: 05.03.2020

⁴⁹ Охридски Рамковен Договор, Секретаријат за спороведување на Охридскиот Рамковен договор, http://www.siofa.gov.mk/data/file/Ramkoven_dogovor_mk.pdf, vizituar më: 03.09.2019, për momentin është “under construction” mund të referohet edhe në <https://www.bdi.mk/documents/MARREVESHJA-E-OHRIT.pdf>

e ardhshëm të Maqedonisë, në një farë mënyre, ajo gjithashtu ishte edhe një marrëveshje paqeje. Në fakt, titulli i pikës dy është qëllimi kryesor i MO - përkatësisht ndërprerja e të gjitha armiqësive dhe kthimi i paqes në Maqedoni, sepse pa paqe asnjë nga dispozitat e tjera të MO nuk do të kishin kuptim.

Pika e tretë e MO-së titullohet “Zhvillimi i pushtetit të decentralizuar”. Kjo pjesë e MO i referohet vetëqeverisjes lokale.

Pika e katërt e MO titullohet “Mos-diskriminimi dhe përfaqësimi i drejtë”. Titulli përbëhet nga dy elemente, i pari është ‘mosdiskriminimi’ dhe i dyti është ‘përfaqësimi i drejtë’. Mosdiskriminimi ka qenë një term në ligjin maqedonas para MO. Nga ana tjetër, termi ‘përfaqësimi i drejtë’ ishte i ri për legjislacionin maqedonas. Ky koncept është i ngjashëm, megjithëse jo identik, me konceptin e diskriminimit pozitiv. Qëllimi i përfaqësimit të drejtë të parashikuar në MO ishte siguri i përfaqësimit adekuat (proporcional me popullsinë totale) të grupeve etnike të punësuar në organet dhe instrumentet shtetërore. Fatkeqësisht, duke pasur parasysh shkallën e lartë të papunësisë në Maqedoni, ky koncept është reduktuar kryesisht në mundësi punësimi në administratën publike.

Pika e pestë: “Procedurat e posaçme kuvendore”. Kjo pikë i referohet sistemit të votimit me anë të shumicës ose 2/3 e votimit në parlament për nxjerrjen e ligjeve që drejtpërsëdrejti kanë të bëjnë me kulturën, përdorimin e gjuhës, arsimin, dokumenteve personale dhe përdorimit të simboleve, si dhe të ligjeve për financim lokal, zgjedhjet vendore etj

Pika gjashtë e MO ka titullin “Arsimimi dhe përdorimi i gjuhëve”. Vetë titulli sugjeron që kjo pjesë adreson çështje që lidhen me arsimin-edukimin dhe përdorimin e gjuhëve. Tri nën-pikat e para të pikës gjashtë kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve në arsim: “Në lidhje me arsimin fillor dhe të mesëm, mësimi do të zhvillohet në gjuhët amtare të studentëve, ndërsa standardet uniforme për programet akademike do të zbatohen në të gjithë Maqedoninë (nën-pika një); Do të sigurohet finansimi nga shteti për arsimin e lartë në gjuhët që flasin të paktën 20% e popullsisë në Maqedoni në bazë të marrëveshjeve të posaçme (nën-pika dy); Parimi i diskriminimit pozitiv do të zbatohet në regjistrimin e studentëve të rinj të universiteteve shtetërore, që u përkasin komuniteteve jo-shumicë në Maqedoni, për sa kohë që regjistrimi nuk pasqyron siç duhet përbërjen e popullatës në Maqedoni. Pika e katërt thotë “Në të gjithë

Republikën e Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare gjuha maqedonase është zyrtare”. Në fakt, kjo nën-pikë nuk paraqiti ndonjë ndryshim, pasi gjuha maqedonase ishte gjuhë zyrtare në të gjithë Maqedoninë, si dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare të Maqedonisë dhe para MO. Pika e gjashtë thotë: “Në lidhje me vetëqeverisjen lokale, në komunat ku një komunitet i caktuar përfshin të paktën 20% të popullsisë në atë komunë, gjuha e këtij komuniteti do të përdoret si gjuhë zyrtare, përveç gjuhës maqedonase. Në lidhje me gjuhët që fliten nga më pak se 20% e popullsisë së bashkisë, autoritetet lokale do të vendosin në mënyrë demokratike për përdorimin e tyre në organet publike”. Për më tepër, nën-pika shtatë flet për të drejtën e personit të akuzuar para procedurave penale dhe civile për të marrë përkthyes me shpenzimet e shtetit. Më në fund, nënparagrafi i fundit i pikës gjashtë thotë “Cilido dokument personal i qytetarëve që flasin një gjuhë zyrtare, përveç maqedonishtes, gjithashtu do të jepen në atë gjuhë, përveç gjuhës maqedonase, në përputhje me ligjin”. Negociatorët shqiptarë kanë insistuar në përmbajtjen e kësaj nën-pike duke favorizuar shqipen si gjuhë të dytë zyrtare.

Pika shtatë e MO titullohet “Shprehja e identitetit” dhe ekziston vetëm një nën-pikë për të cilën mund të konkludojmë se pika shtatë e cila duhet të merret me çështje që ndërlidhen me shprehjen e identitetit është reduktuar vetëm në rregullimin e vendosjes së simbolit të komunitetit të shumicës në një komunë të caktuar.⁵⁰ Në praktikë, në nivelin komunal, vetëm bashkësia shqiptare është në shumicën e komunave ku komuniteti maqedonas nuk është shumicë, me përjashtime të rralla, siç është komuna e Shuto Orizari, e cila ka një shumicë të popullatës rome. Rrjedhimisht, vetëm simbolet maqedonase (shtetërore) dhe shqiptare (etnike) vendosen para ndërtesave publike lokale, domethënë, promovohet shprehja bietike e identitetit, përkundrajt multietnicitetit të promovuar në mënyrë deklarative. Fatkeqësisht, MO në pjesën që merret me çështjen e shprehjes së identitetit, e cila është çështje e një natyre personale dhe madje një koncept filozofik, zbrit në rregullimin e thjeshtë të rregullave për vendosjen e flamujve të caktuar. Kjo zgjidhje u nxit disi nga ngjarjet e 9 korrikut 1997 në Gostivar.

Praktikisht, nga ajo që u cek më sipër, mund të konkludohet se me nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, ushtarët e UCK ranë dakord për armëpushim në qershor, por megjithatë, ata, vazhduan të qëllonin në shënjestrat e policisë maqedonase. Nënshkruesit e drejtpërdrejtë të Marrëveshjes së Ohrit janë autoritetet maqedonase, të udhëhequra nga Presidenti

⁵⁰ <https://www.bdi.mk/documents/MARREVESHJA-E-OHRIT.pdf> vizituar më: 03.03.2020

Boris Trajkovski dhe Kryeministri Ljubčo Georgievski dhe lideri i opozitës së LSDM Branko Crvenkovski, dhe pala shqiptare e udhëhequr nga Arben Xhaferi dhe Imer Imeri, Fransoa Leotar (përfaqësues nga UE) dhe Xhejms Perdju (Ndërmjetësues nga SHBA). Me këtë marrëveshje, popullatës shqiptare që jeton në Republikën e Maqedonisë u janë premtuar të drejta më të mëdha, duke përfshirë: ngritjen e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare të shtetit, rritjen e numrit të shqiptarëve etnikë në administrimin e administratës shtetërore, në polici dhe ushtri; dhe miratimi i një plani të ri të decentralizimit.

Nga ana tjetër, përfaqësuesit shqiptarë ranë dakord që të heqin dorë nga të gjitha pjesëmarrjet separatiste dhe të njohin të gjitha institucionet shtetërore. Në këtë drejtim, ushtarët e UÇK u çarmatosën nga pakti i NATO-s. UÇK-ja do që të përfitojë nga mundësitë e ofruara nga ana e Qeverisë për t'u riintegruar në shoqëri në përputhje me planin e kryetarit Trajkovski dhe në përputhje me Programin për tejkalim të krizës. Në këtë kontekst, UÇK-ja mirëpret dhe pranon deklaratën e shkruar nga ana e kryetarit Trajkovski drejtuar Sekretarit gjeneral të NATO-s të 13 gushtit 2001, se Qeveria e Maqedonisë do të ofrojë imunitet prej veprimeve penale për të gjithë ish anëtarët e UÇK-së të cilët vullnetarisht janë çarmatosur, në përjashtim të atyre për të cilët dyshohet se kanë kryer krime të cilat janë kompetencë e Tribunalit për Krime të Kombeve të Bashkuara për ish-Jugosllavinë.⁵¹

Marrëveshja Kornizë e Ohrit është një dokument i nënshkruar gjatë konfliktit të armatosur në territorin e Republikës së Maqedonisë. Pra, Marrëveshja u nënshkrua midis përfaqësuesve të dy partive më të mëdha maqedonase dhe dy partive më të mëdha shqiptare në Maqedoni. Poashtu, edhe komuniteti ndërkombëtar është nënshkruar i kësaj marrëveshje dhe garantuesi i saj. E njëjta marrëveshje është përfshirë në kushtetutën e Maqedonisë sot.

⁵¹ http://www.kosovaelire.com/irjm_carmatosja_nato_uck.php vizituar më: 09.03.2020

KAPITULLI III:

Republika e Maqedonisë në skenën ndërkombëtare dhe raportet me fqinjët

3.1. Marrëdhëniet midis R. së Maqedonisë dhe R. së Shqipërisë

Republika e Maqedonisë dhe Republika e Shqipërisë vendosën marrëdhënie diplomatike më 26 prill 1993. Të dy vendet kanë ndërtuar marrëdhënie dhe bashkëpunim të mirë, gjë që reflektohet në vizita dhe takime të shumta bilaterale në të gjitha nivelet.

Traktati, emri zyrtar i të cilit është *marrëveshja përfundimtare e zgjidhjes së dallimeve të përshkruara në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 817 (1993) dhe 845 (1993), përfundon vlefshmërinë e Marrëveshjes së Përkohshme të vitit 1995, dhe për krijimin e partneritetit strategjik midis palëve, kërkon që Republika e Maqedonisë të ndryshojë emrin e saj kushtetues në “Republikën e Maqedonisë së Veriut” ose në anglisht “Republic of North Macedonia”, duke përkthyer në të gjitha gjuhët, shtetsia të jetë “Maqedonase” / “qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut”, dhe gjuha zyrtare e shtetit duhet të vazhdojë të emërohet si gjuhë maqedonase dhe të njihet nga Republika e Greqisë. Këtë e konfirmoi edhe Zoran Zaev, i cili në një konferencë për shtyp në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë deklaroi se marrëveshja do të njohë gjuhën maqedonase në Kombet e Bashkuara, dhe qytetarët do të thirren, si më parë, maqedonas. Sipas Marrëveshjes së Prespës, kodet e vendit mbeten MK dhe MKD, me përjashtim të targave ku do të aplikohet NM ose NMK, ndërsa termat “Maqedoni” dhe “Maqedonaset” mund të përdoren për territorin, gjuhën, popullin, historinë, kulturën dhe trashëgiminë e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Parashihet krijimi i një komiteti të përbashkët interdisiplinar të ekspertëve për çështjet historike, arkeologjike dhe edukative, si dhe për përmirësimin e bashkëpunimit diplomatik, politik, ekonomik, arsimor, policor dhe mbrojtës.⁹¹*

Realizimi i Marrëveshjes së Prespës mund të shihet nga deklaratat në faqen zyrtare të Qeverisë në internet, në pjesën që njofton ndryshimet e amandamenteve XXXIII, XXXIV, XXXV dhe XXXVI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, të cilat Parlamenti i Republikës së Maqedonisë i miratoi në seancën e mbajtur më 11 janar të vitit 2019.⁹²

⁹¹ <https://respublica.edu.mk/blog/2018-09-14-08-02-16> vizituar më: 05.03.2020

⁹² <https://vlada.mk/node/14958> vizituar më: 05.03.2020

Amandamentet XXXIII, XXXIV, XXXV dhe XXXVI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë janë pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe do të hyjnë në fuqi pas fuqizimit të Marrëveshjes përfundimtare të zgjidhjes së dallimeve të përkruara në rezolutat 817 (1993) dhe 845 (1993) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, për të ndaluar vlefshmërinë e Marrëveshjes së Përkohshme të vitit 1995 dhe për të krijuar partneritet strategjik midis palëve dhe për të ratifikuar Protokolin e Parë të Aderimit për pranimin në NATO.

Amandamenti XXXIII shprehet se në Kushtetutë, fjalët “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut” dhe fjala “Maqedoni” zëvendësohet me fjalët: “Maqedonia e Veriut”, përveç në nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.⁹³

Amandamenti XXXIV thotë se në Preambulën e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë fshihen fjalët “si dhe qytetarët që jetojnë brenda kufijve të saj të cilët janë”, “vendimet e ASNOM” zëvendësohen me fjalët: “vendimet ligjore të përmendura në Deklaratën e parë të mbledhjes së ASNOM para popullit maqedonas për takimin ASNOM “, pas fjalës “vit” shtohen fjalët “e cila shprehu dëshirën për krijimin e një shteti të pavarur sovran dhe Marrëveshjen Kornizë të Ohrit”, ndërsa fshihen fjalët: “vendosën që”. Me këtë amandament ndryshohet Preambula - Amandamenti IV i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

Në amandamentin që pason, XXXV, thuhet që Republika respekton sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë politike të shteteve fqinje. Ky ndryshim plotëson nenin 3 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

Amandamenti XXXVI. Në të thuhet se Republika mbron, garanton dhe kultivon veçoritë, trashëgiminë historike dhe kulturore të popullit maqedonas. Republika mbron të drejtat dhe interesat e qytetarëve të saj që jetojnë ose banojnë jashtë vendit. Republika kujdeset për diasporën e popullit maqedonas dhe një pjesë të popullit shqiptar, popullin turk, popullin vllleh, popullin Sërb, popullin romë, popullin boshnjak dhe të tjerët, kultivon dhe promovon lidhjet me atdheun e tyre. Republika nuk do të ndërhyjë në të drejtat sovrane të shteteve të tjera dhe në

⁹³ Ibid

punët e tyre të brendshme. Me këtë amandament zavendësohet neni 49 dhe amandamenti II i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.⁹⁴

Më poshtë do të kemi një shpjegim të shkurtër të ndryshimeve të përmendura më parë që janë objekt i Marrëveshjes së Prespës.

Përkatësisht, qëllimi i ndryshimeve në amandamentin XXXIII është zbatimi i Marrëveshjes Përfundimtare me Greqinë, e cila duhet të mundësojë pranimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian dhe NATO. Sipas Marrëveshjes përfundimtare me Republikën e Greqisë, parashihet që ndryshimet të hyjnë në fuqi ditën e ratifikimit të Marrëveshjes dhe Protokolit për pranimin në NATO nga Parlamenti i Republikës së Greqisë. Rrjedhimisht, në rast se këto dy dokumente nuk hyjnë në fuqi, ndryshimet e parashikuara nuk do të fuqizohen. Për më tepër, në përputhje me marrëveshjen, ligji kushtetues do të përcaktojë zbatimin e dispozitës në lidhje me vlefshmërinë e dokumenteve dhe materialeve tashmë ekzistuese të lëshuara nga autoritetet e Republikës së Maqedonisë.

Qëllimi i ndryshimeve kushtetuese përmes amendamentit XXXIV është zbatimi i Marrëveshjes Përfundimtare me Greqinë, e cila duhet të mundësojë pranimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian dhe NATO. Për të sjellë tekstin e Preambulës në përputhje me Marrëveshjen Përfundimtare me Greqinë, Preambula do të pësojë ndryshime përkatëse. Preambula e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë heq kufizimet për popujt dhe pjesët e tyre që jetojnë jashtë shtetit të tyre. Kur iu referohen traditave juridiko-shtetërore, emërtohen vendimet juridike të ASNOMIT-it, të cilat përcaktohen në Njoftimin e mbledhjes së Parë të ASNOMIT-it për popullin maqedonas për seancën e mbajtur të ASNOM-it. Preambula përmend gjithashtu Marrëveshjen Kornizë të Ohrit, e cila tashmë është përfshirë në ndryshimet kushtetuese të vitit 2001.

Qëllimi i ndryshimeve në amandamentin XXXV të Kushtetutës është zbatimi i Marrëveshjes Përfundimtare me Greqinë, e cila duhet të mundësojë pranimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian dhe NATO. Marrëveshja përfundimtare pohon kufirin ekzistues midis Republikës së Maqedonisë dhe Greqisë si një kufi ndërkombëtar i përhershëm dhe i paprekshëm, duke marrë përsipër që asnjëra nga të dy shtetet të mos ketë e as të mbështesë

⁹⁴ <https://vlada.mk/node/14958> vizituar më: 05.03.2020

ndonjë pretendim në ndonjë pjesë të territorit të shtetit tjetër, e as pretendime për të ndryshuar kufirin e tyre ekzistues. Për më tepër, Republika e Maqedonisë dhe Greqia janë zotuar të mos mbështesin pretendimet që mund të bëhen nga palët e treta. Republika e Maqedonisë dhe Greqia janë zotuar të respektojnë sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë politike të shtetit tjetër dhe të mos mbështesin asnjë veprimtari të palës së tretë të drejtuar kundër sovranitetit, integritetit territorial ose pavarësisë politike të shtetit tjetër.

Të dy Shtetet kanë marrë përsipër, në përputhje me qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara,⁹⁵ të përmbahen nga kërcënimet ose përdorimi i forcës, përfshirë kërcënimet ose përdorimin e forcës, me qëllim të shkeljes së kufirit të tyre ekzistues.

Neni 3 i Kushtetutës parasheh që territori i Republikës së Maqedonisë është i pandashëm dhe i patjetërsueshëm. Kufiri ekzistues i Republikës së Maqedonisë është i paprekshëm. Republika e Maqedonisë nuk ka pretendime territoriale ndaj shteteve fqinje. Kufiri i Republikës së Maqedonisë mund të ndryshohet vetëm në përputhje me Kushtetutën dhe në parimin e vullnetarizimit dhe në përputhje me normat ndërkombëtare përgjithësisht të pranuar.⁹⁶

Ky nen u ndryshua në vitin 1992 me amandamentin I, kur u shtua parimi i vullnetarizimit për ndryshimin e kufirit dhe pajtueshmëria me normat përgjithësisht të pranuar ndërkombëtare. Gjithashtu, me këtë amandament u deklarua se Republika e Maqedonisë nuk kishte pretendime territoriale ndaj shteteve fqinje.

Me amandamentin e ri kushtetues që propozohet, deklarohet respektim për sovranitetin, integritetin territorial dhe pavarësinë politike të shteteve fqinje.

Qëllimi i ndryshimeve në Amandamentin XXXVI të Kushtetutës është zbatimi i Marrëveshjes Përfundimtare me Greqinë, e cila duhet të mundësojë pranimin e Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian dhe NATO. Në bazë të Marrëveshjes përfundimtare, Republika e Maqedonisë dhe Greqia, obligohen që asnjë dispozitë e Kushtetutës mos interpretohet në atë mënyrë që përbën ose do të përbëjë ndonjëherë bazë për ndërhyrje në punët e

⁹⁵ http://www.pp.gov.al/web/karta_e_okb_770.pdf (Karta e Kombeve Të Bashkuara) vizituar më 05.03.2020

⁹⁶ <https://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/Kushtetuta%20e%20RM-se%20Final%20ALB.pdf> vizituar më: 06.03.2020

brendshme të shtetit tjetër, në çfarëdo forme ose për çfarëdo arsye, përfshirë mbrojtjen e statusit dhe të drejtave të njerëzve që nuk janë shtetas të saj.

Neni 49 i Kushtetutës përcakton që Republika të kujdeset për pozicionin dhe të drejtat e popullit maqedonas në vendet fqinje dhe mërgimtarët nga Maqedonia, të ndihmojë zhvillimin e tyre kulturor dhe të promovojë marrëdhëniet e tyre me ta. Republika të kujdeset për të drejtat kulturore, ekonomike dhe sociale të qytetarëve të Republikës jashtë vendit. Republika nuk do të ndërhyjë në të drejtat sovrane të shteteve të tjera dhe në punët e tyre të brendshme.

Ky artikull gjithashtu u ndryshua nga amendamenti II në vitin 1992, i cili parashikonte që Republika të mos ndërhynte në të drejtat sovrane të shteteve të tjera dhe punët e tyre të brendshme.

Ndryshimi i propozuar kushtetues thekson detyrimin e Republikës së Maqedonisë për të mbrojtur, garantuar dhe kultivuar veçoritë, trashëgiminë historike dhe kulturore të popullit maqedonas. Gjithashtu, ndryshimi garanton mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të shtetasve që jetojnë ose banojnë jashtë vendit. Amendamenti përcakton që Republika të kujdeset për diasporën, si për popullin maqedonas ashtu edhe për komunitetet e tjera, duke nxitur dhe avancuar lidhjet e tyre me atdheun pa ndërhyrë në të drejtat sovrane të shteteve të tjera dhe punët e tyre të brendshme.⁹⁷

⁹⁷ <https://vlada.mk/node/14958> vizituar më: 05.03.2020

KAPITULLI IV:

Rezultatet e hulumtimit

1. Të anketuarit dhe ekzemplarë

Për qëllimin e hulumtimit, u përgatit një pyetësor për të anketuarit (studentët). Hulumtimi është kryer kryesisht nga studentë të Tetovës dhe Shkupit. Pyetësi iu është shpërndarë të anketuarve përmes mjetit softuerik MonkeySurvey.

Në sondazh, fillimisht ishte planifikuar të përfshiheshin vetëm 100 studentë nga Tetova, por gjatë realizimit të anketës, studentë të tjerë (të intervistuar) nga Shkupi ranë dakord t'i përgjigjen pyetësorit, duke rritur kështu numrin e të anketuarve në 216 studentë.

Të anketuarit janë të grupmoshave të ndryshme pa mos e kufizuar moshën, dhe poashtu i përkasin nacionaliteteve dhe konfesioneve fetare të ndryshme me qëllim të nxjerrjes së rezultateve sa më të përafërta për ta vërtetuar tezën tonë gjenerale dhe tezat ndihmëse.

Pyetësi u formulua në gjuhën maqedone për mos u shkaktuar konfuzion në mesin e të anketuarve, duke patur parasyshë që gjuhën maqedonase e flasin të gjithë komunitetet që jetojnë dhe funksionojnë në R. e Maqedonisë, mirëpo gjatë hulumtimit tonë, nga shkaku që punimi është në gjuhën shqipe, pyetësi bashkë me përgjigjet u përkthye dhe rezultatet do ti paraqesim në gjuhën shqipe.

Sondazhi u kry në nëntor dhe dhjetor 2019. Pyetësi ishte i tipit të mbyllur dhe përmbante 20 pyetje të adaptuara, d.m.th. pohime të destinuara për studentët e universiteteve në Tetovë dhe Shkup, ku të anketuarit kishin mundësinë të zgjidhnin njëren nga tre opsionet e ofruara për përgjigje A = JO), B = PJESËRISHT). dhe C = PO).

Në vazhdim është përmbledhja e rezultateve të përfituara nga të anketuarit, gjegjësisht 216 të anketuar, të cilët u përfshinë në hulumtimin e qëndrimeve të tyre në lidhje me marrëdhëniet e Republikës së Maqedonisë me fqinjët pas vitit 2001.

2. Rezultatet e hulumtimit dhe analiza

Hulumtimi, siç u përmend tashmë, u realizua me pjesëmarrjen e studentëve nga Tetova dhe Shkupi, përmes mjetit softuerik MonkeySurvey.

Edhe pse fillimisht ishte planifikuar që të anketohen e rreth 100 studentë, deri në kohën kur mbledhja e të dhënave ishte e përfunduar, gjithsej anketës iu përgjigjën 216 të anketuar.

Pyetësi përmbante gjithsej 20 pyetje ose pretendime. Ata ishin të tipit të mbyllur dhe pyetësi ishte anonim me qëllim që me anë të kësaj ankete të mblidhen të dhëna sa më të besueshme për të nxjerrur një pasqyrë sa më reale në lidhje me marrëdhëniet e shtetit tonë me fqinjët. Të dhënat e marra gjatë hulumtimit u analizuan dhe përfundimet u përmbledhën.

Me kryerjen e këtij hulumtimi, është e nevojshme të konfirmohen hipotezat specifike të këtij punimi dhe të vërtetohet se Republika e Maqedonisë ka marrëdhënie shumë të mira me fqinjët e saj të banuar me shtetas kryesisht shqiptarë, që janë Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës, ndërsa, nga ana tjetër, ka disa mosmarrëveshje dhe pengesa politike me shtetet fqinje që nuk janë me shumicë shqiptare, siç janë Republika e Sërbisë, Republika e Bullgarisë dhe Republika e Greqisë.

Pyetjet e mëposhtme janë pjesë përbërëse e pyetësorit të anketës që përmbajnë gjithsej 20 pyetje (pretendime). Për hulumtimin e zhvilluar u përdor mënyra e shkallëzimit të metodës së Likertit.

Në shkallëzimin, pyetësi i parë ka 3 pikëpamje të mundshme për: 1 (A) - jo; 2 (B) - pjesërisht; dhe 3 (C) - po. Rezultatet janë paraqitur në tabelë, me mesatare të pikëpamjeve të marra nga të anketuarit, në mënyrë që më vonë, secila prej pikëpamjeve ose pretendimeve të paraqitet në përqindje në tabelë të përshtatshme.

Të anketuarit ishin informuar më parë se pyetësi është anonim dhe do të përdoret ekskluzivisht për studime master, dmth për kërkime shkencore me temën “Marrëdhëniet e Republikës së Maqedonisë me fqinjët pas vitit 2001”. Përgjigjet e pyetësorit janë konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për qëllime shkencore për të nxjerrë përfundime të përgjithshme pa paraqitur përgjigje individuale

Pyetësori për qëndrimet e të anketuarve në lidhje me marrëdhëniet e Republikës së Maqedonisë me fqinjët pas vitit 2001

Nr. Ren.	Pyetjet/ Pohimet	1	2	3	Mesatarja
1	A mendoni se Republika e Maqedonisë ka disa mosmarrëveshje me Republikën e Bullgarisë?	20	14	182	2.75
2	A jeni të informuar me problemet/çështjet që paraqesin sfida për Maqedoninë dhe Bullgarinë?	23	32	161	2.63
3	Mendoj që problemi më i madh midis Maqedonisë dhe Bullgarisë është mosmarrëveshja për gjuhën dhe historinë.	30	34	152	2.70
4	Marrëdhëniet që ka Maqedonia me Sërbinë mendoj se nuk janë mjaft të sqarta dhe pozitive.	21	41	154	2.71
5	A mendoni se problemi më i madh midis Maqedonisë dhe Sërbisë është mospranimi i autoqefalitetit të KOM?	26	21	169	2.78
6	A mendoni që problemi fetar i Maqedonisë me Sërbinë do të zgjidhet ndonjëherë bashkarisht?	79	43	94	2.47
7	A e shihni të rëndësishme funksionin mbështetës në punën tuaj?	34	21	161	2.74
8	Mendoj që një prej mosmarrëveshjeve midis Maqedonisë dhe Sërbisë është edhe problemi që ka Serbia në lidhje me njohjen e Kosovës nga ana e Maqedonisë	33	21	162	2.75
9	Mendoj se është e rëndësishme mbyllja e çështjes së emrit, Maqedonia dhe Greqia të arrijnë marrëveshje që do ta çojë Maqedoninë përpara.	64	43	109	2.50
10	Mendoj që Maqedonia kishte problem serioz me mosnjohjen e emrit kushtetues të vendit nga ana e Greqisë	16	52	148	2.68
11	Besoj se Republika e Maqedonisë ka shfrytëzuar maksimumin me marrëveshjen e arritur me Republikën e Greqisë dhe nuk ka më çështje të hapura midis dy vendeve.	36	21	159	2.73
12	Trendi i tejkalimit të problemeve të ndryshme politike me të cilat përballlet Republika e Maqedonisë është i dukshëm	10	29	177	2.81
13	Besoj që Republika e Maqedonisë deri më sot ka arritje dhe suksese të caktuara në skenën politike ndërkombëtare, pra në marrëdhëniet me fqinjët e saj.	26	52	138	2.63
14	Besoj që Republika e Maqedonisë ka marrëdhënie jashtëzakonisht të mira me fqinjët e saj, ku kryesisht janë të banuara me shqiptarë.	27	23	166	2.76
15	Besoj që Republika e Maqedonisë ka disa	22	27	177	2.91

	mosmarrëveshje dhe disa pengesa politike me shtetet që nuk kanë shumicë shqiptare.				
16	Mendoj që Republika e Maqedonisë ka marrëdhënie shumë të mira me Republikën e Kosovës dhe nuk kanë çështje të hapura dhe të pazgjidhura reciproke.	10	26	180	2.83
17	Mendoj që Republika e Maqedonisë ka marrëdhënie shumë të mira me Republikën e Shqipërisë dhe nuk kanë çështje të hapura dhe të pazgjidhura reciproke.	14	16	186	2.86
18	Mendoj që gjithmonë ka hapësirë për përmirësimin e politikave midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë.	28	39	149	2.68
19	Mendoj që gjithmonë ka hapësirë për përmirësimin e politikave midis Republikës së shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë	30	47	139	2.64
20	Në përgjithësi, besoj që Republika e Maqedonisë ka aftësi të krijojë marrëdhënie të mira me të gjithë fqinjët e saj.	29	37	150	2.69

Tabela e mësipërme tregon përgjigjet totale të të anketuarve bazuar në të gjitha 20 pyetjet, si dhe mesataren e llogaritur për secilën prej tyre.

Më poshtë tregohet përqindja, si dhe rezultatet vizuale (grafike) të secilës prej përgjigjeve individualisht.


1. Në fillim, pohimi i parë që u përshtat dhe iu paraqit opinionit të hulumtimit, dmth pyetja e parë për të anketuarit ishte *A mendoni që Republika e Maqedonisë ka disa mosmarrëveshje me Republikën e Bullgarisë?*

Në lidhje me këtë pyetje nga gjithsej 216 të anketuar, u morën rezultatet e mëposhtme:

A) JO 20

B) PJESËRISHT 14

C) PO 182



Grafikoni nr. 1 - Përgjigjet e pyetjes nr. 1


2. Pyetja/pohimi i dytë, i cili është përshtatur dhe u është parashtruar të anketuarve, thotë: *A jeni të informuar me problemet/çështjet që paraqesin sfida për Maqedoninë dhe Bullgarinë?*

Në lidhje me këtë pyetje nga gjithsej 216 të anketuar, u morën rezultatet e mëposhtme:

A) JO 23

B) PJESËRISHT 32

C) PO 161



Grafikoni nr. 2 - Përgjigjet në pyetjen nr. 2


3. Pyetja/pohimi i tretë, i cili është përshtatur dhe u është parashtruar të anketuarve, thotë: *Mendoj që problemi më i madh midis Maqedonisë dhe Bullgarisë është mosmarrëveshja për gjuhën dhe historinë.*

Rezultatet e mëposhtme u morën nga gjithsej 216 të anketuar:

A) JO 30

B) PJESËRISHT 34

C) PO 152



Grafikoni nr. 3 - Përgjigjet në pyetjen nr. 3


4. Pyetja/pohimi i katërt, i cili është përshtatur dhe u është parashtruar të anketuarve, thotë:
Marrëdhëniet që ka Maqedonia me Serbinë mendoj se nuk janë mjaft të sigërtë dhe pozitive.

Rezultatet e mëposhtme u morën nga gjithsej 216 të anketuar:

A) JO 21

B) PJESËRISHT 41

C) PO 154



Grafikoni nr. 4 - Përgjigjet në pyetjen nr. 4


5. Pyetja/pohimi i pestë, i cili është përshtatur dhe u është parashtruar të anketuarve, thotë: *A mendoni se problemi më i madh midis Maqedonisë dhe Serbisë është mospranimi i autoqefalitetit të KOM?*

Rezultatet e mëposhtme u morën nga gjithsej 216 të anketuar:

A) JO 26

B) PJESËRISHT 21

C) PO 169



Grafikoni nr. 5 - Përgjigjet në pyetjen nr. 5


6. Pyetja/pohimi i gjashtë, i cili është përshtatur dhe u është parashtruar të anketuarve, thotë: *A mendoni që problemi fetar i Maqedonisë me Serbinë do të zgjidhet ndonjëherë bashkarisht?*

Rezultatet e mëposhtme u morën nga gjithsej 216 të anketuar:

A) JO 79

B) PJESËRISHT 43

C) PO 94



Grafikoni nr. 6 - Përgjigjet në pyetjen nr. 6


7. Pyetja/pohimi i shtatë, i cili është përshtatur dhe u është parashtruar të anketuarve, thotë: *A e shihni të rëndësishëm funksionin mbështetës në punën tuaj?*

Rezultatet e mëposhtme u morën nga gjithsej 216 të anketuar

A) JO 34

B) PJESËRISHT 21

C) PO 161



Grafikoni nr. 7 - Përgjigjet në pyetjen nr. 7


8. Pyetja/pohimi i tetë, i cili është përshtatur dhe u është parashtruar të anketuarve, thotë: *Mendoj që një prej mosmarrëveshjeve midis Maqedonisë dhe Serbisë është edhe problemi që ka Serbia në lidhje me njohjen e Kosovës nga ana e Maqedonisë*

Rezultatet e mëposhtme u morën nga gjithsej 216 të anketuar

A) JO 33

B) PJESËRISHT 21

C) PO 162



Grafikoni nr. 8 - Përgjigjet në pyetjen nr. 8


9. Pyetja/pohimi i nëntë, i cili është përshtatur dhe u është parashtruar të anketuarve, thotë: *Mendoj se është e rëndësishme mbyllja e çështjes së emrit, Maqedonia dhe Greqia të arrijnë marrëveshje që do ta çojë Maqedoninë përpara.*

Rezultatet e mëposhtme u morën nga gjithsej 216 të anketuar:

A) JO 64

B) PJESËRISHT 43

C) PO 109



Grafikoni nr. 9 - Përgjigjet në pyetjen nr. 9


10. Pyetja/pohimi i dhjetë, i cili është përshtatur dhe u është parashtruar të anketuarve, thotë: *Mendoj që Maqedonia kishte problem serioz me mosnjohjen e emrit kushtetues të vendit nga ana e Greqisë*

Rezultatet e mëposhtme u morën nga gjithsej 216 të anketuar

A) JO 16

B) PJESËRISHT 52

C) PO 148



Grafikoni nr. 10 - Përgjigjet në pyetjen nr. 10


11. Pyetja/pohimi i njëmbëdhjetë, i cili është përshtatur dhe u është parashtruar të anketuarve, thotë: *Besoj se Republika e Maqedonisë ka shfrytëzuar maksimumin me marrëveshjen e arritur me Republikën e Greqisë dhe nuk ka më çështje të hapura midis dy vendeve.*

Rezultatet e mëposhtme u morën nga gjithsej 216 të anketuar

A) JO 36

B) PJESËRISHT 21

C) PO 159



Grafikoni nr. 11 - Përgjigjet në pyetjen nr. 11


12. Pyetja/pohimi i dymbëdhjetë, i cili është përshtatur dhe u është parashtruar të anketuarve, thotë: *Trendi i tejkalimit të problemeve të ndryshme politike me të cilat përballet Republika e Maqedonisë është i dukshëm*

Rezultatet e mëposhtme u morën nga gjithsej 216 të anketuar

A) JO 10

B) PJESËRISHT 29

C) PO 177



Grafikoni nr. 12 - Përgjigjet në pyetjen nr. 12


13. Pyetja/pohimi i trembëdhjetë, i cili është përshtatur dhe u është parashtruar të anketuarve, thotë: *Besoj që Republika e Maqedonisë deri më sot ka arritje dhe suksese të caktuara në skenën politike ndërkombëtare, pra në marrëdhëniet me fqinjët e saj.*

Rezultatet e mëposhtme u morën nga gjithsej 216 të anketuar

A) JO 26

B) PJESËRISHT 52

C) PO 138



Grafikoni nr. 13 - Përgjigjet në pyetjen nr. 13


14. Pyetja/pohimi i katërmbëdhjetë, i cili është përshtatur dhe u është parashtruar të anketuarve thotë: *Besoj që Republika e Maqedonisë ka marrëdhënie jashtëzakonisht të mira me fqinjët e saj, ku kryesisht janë të banuara me shqiptarë.*

Rezultatet e mëposhtme u morën nga gjithsej 216 të anketuar:

A) JO 27

B) PJESËRISHT 23

C) PO 166



Grafikoni nr. 14 - Përgjigjet në pyetjen nr. 14


15. Pyetja/pohimi i pesëmbëdhjetë, i cili është përshtatur dhe u është parashtruar të anketuarve, thotë: *Besoj që Republika e Maqedonisë ka disa mosmarrëveshje dhe disa pengesa politike me shtetet që nuk kanë shumicë shqiptare.*

Rezultatet e mëposhtme u morën nga gjithsej 216 të anketuar:

A) JO 22

B) PJESËRISHT 27

C) PO 177



Grafikoni nr. 15 - Përgjigjet në pyetjen nr. 15


16. Pyetja/pohimi i gjashtëmbëdhjetë, i cili është përshtatur dhe u është parashtruar të anketuarve, thotë: *Mendoj që Republika e Maqedonisë ka marrëdhënie shumë të mira me Republikën e Kosovës dhe nuk kanë çështje të hapura dhe të pazgjidhura reciproke.*

Rezultatet e mëposhtme u morën nga gjithsej 216 të anketuar

A) JO 10

B) PJESËRISHT 26

C) PO 180



Grafikoni nr. 16 - Përgjigjet në pyetjen nr. 16


17. Pyetja/pohimi i shtatëmbëdhjetë, i cili është përshtatur dhe u është parashtruar të anketuarve, thotë: *Mendoj që Republika e Maqedonisë ka marrëdhënie shumë të mira me Republikën e Shqipërisë dhe nuk kanë çështje të hapura dhe të pazgjidhura reciproke.*

Rezultatet e mëposhtme u morën nga gjithsej 216 të anketuar

A) JO 14

B) PJESËRISHT 16

C) PO 186



Grafikoni nr. 17 - Përgjigjet në pyetjen nr. 17


18. Pyetja/pohimi i tetëmbëdhjetë, i cili është përshtatur dhe u është parashtruar të anketuarve, thotë: *Mendoj që gjithmonë ka hapësirë për përmirësimin e politikave midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë.*

Rezultatet e mëposhtme u morën nga gjithsej 216 të anketuar:

A) JO 28

B) PJESËRISHT 39

C) PO 149



Grafikoni nr. 18 - Përgjigjet në pyetjen nr. 18


19. Pyetja/pohimi i nëntëmbëdhjetë, i cili është përshtatur dhe u është parashtruar të anketuarve, thotë: *Mendoj që gjithmonë ka hapësirë për përmirësimin e politikave midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë*

Rezultatet e mëposhtme u morën nga gjithsej 216 të anketuar:

A) JO 30

B) PJESËRISHT 47

C) PO 139



Grafikoni nr. 19 - Përgjigjet në pyetjen nr. 19


20. Pyetja/pohimi i njëzetë dhe e fundit, i cili është përshtatur dhe u është parashtruar të anketuarve, thotë, është si vijon: *Në përgjithësi, besoj që Republika e Maqedonisë ka aftësi të krijojë marrëdhënie të mira me të gjithë fqinjët e saj.*

Rezultatet e mëposhtme u morën nga gjithsej 216 të anketuar:

A) JO 29

B) PJESËRISHT 37

C) PO 150



Grafikoni nr. 20 - Përgjigjet në pyetjen nr. 20

Për të konfirmuar dhe vërtetuar hipotezat dhe pohimet e bëra, u bë një analizë cilësore e rezultateve të hulumtimit. Për këtë qëllim, përgjigjet e marra janë grupuar në bazë të indikatorëve nga të cilët janë nxjerrë dhe janë notuar dhe llogaritur siç duhet.

Notimi dhe llogaritja bëhet në mënyrë që:

- secila përgjigje A) merr 1 pikë,
- secila përgjigje B) merr 2 pikë dhe
- secila përgjigje C) merr 3 pikë.

Numri maksimal i pikëve që mund të nxirren nga një pyetje ose pohim (duke supozuar se të gjithë të anketuarit janë përgjigjur me përgjigjen nën C) është shuma e numrit të të anketuarve shumëzuar me 3, dhe minimumi është shuma e numrit të të anketuarve shumëzuar me 1 (duke supozuar se të gjithë të anketuarit janë përgjigjur me përgjigjen nën A).

Pikat e marra pjestohen me numrin e të anketuarve, duke siguruar kështu mesatare aritmetike për pohimin konkret ose për pyetjen konkrete.

Për të llogaritur variablën e secilës hipotezë, numri i përgjithshëm i pikave nga pohimet, pra pyetjet, që përbëjnë indikatorët e variablës konkrete, mblidhen dhe pjestohen me numrin e pohimeve ose pyetjeve.

Për të vërtetuar hipotezën, vlerat e përfituara nga variabla e pavarur përkatëse krahasohen me variablën e varur përkatëse.

Llogaritet mesi aritmetik i secilës pyetje, dhe më pas e secilës variabël hulumtuese. Rezultati mund të shkojë nga minimumi 1 deri në maksimum 3.

Nëse mesatarja aritmetike është më e madhe se 1.5, variabla konfirmohet, dhe nëse mesatarja aritmetike është më e vogël se 1.5, hudhet.

Nëse konfirmohet edhe variabla e varur edhe e pavarur e një hipoteze, atëherë hipoteza vërtetohet.

Gjithashtu, nëse refuzohet edhe variabla e varur edhe e pavarur e një hipoteze, hipoteza përsëri vërtetohet.

Hipoteza gjenerale e përcaktuar në hulumtim ishte:

“R. e Maqedonisë ka marrëdhënie shumë të mira me fqinjët ku kryesisht jetojnë popullatë shqiptare, si R. e Shqipërisë dhe R. e Kosovës, e nga ana tjetër, ekzistojnë disa problematika të thella dhe pengesa politike me shtetet fqinje që nuk janë të banuara me popullatë shqiptare, si, R. E Sërbisë, R. E Bullgarisë dhe R. E Greqisë”

Përgjigjet e marra nga të anketuarit:

Pyetja/ Pohimi	A- JO	B- PJESËRISHT	C- PO	Σ të anketuarve
1	20	14	182	216
2	23	32	161	216
3	30	34	152	216
4	21	41	154	216
5	26	21	169	216
6	79	43	94	216
7	34	21	161	216
8	33	21	162	216
9	64	43	109	216
10	16	52	148	216
11	36	21	159	216
12	10	29	177	216
13	26	52	138	216
14	27	23	166	216
15	22	27	177	216
16	10	26	180	216
17	14	16	186	216
18	28	39	149	216
19	30	47	139	216
20	29	37	150	216

Tabela e mësipërme përmbledh përgjigjet e tabeluara (të përmbledhura) të marra nga të anketuarit. Vlen të përmendet që të gjithë të anketuarit dhanë përgjigjen e tyre, ose mendimin e tyre për pyetjet ose pohimet që përbëjnë pyetësorin e anketës.

Tabela e mëposhtme tregon pikët e llogaritura sipas përgjigjeve të dhëna nga të anketuarit, sipas metodologjisë së paraqitur më parë, d.m.th. për secilën përgjigje nën A = 1 pikë, për secilën përgjigje nën B = 2 pikë, dhe për secilën përgjigje nën C = 3 pikë.

Si përmbledhje, koeficientët e llogaritur për secilën pyetje individualisht, si dhe shumën që do të konfirmonte hipotezën e përgjithshme, janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Pika të llogaritura nga popullata e anketuar

Pyetja/pohimi	A- JO	B- PJESËRISHT	C- PO	Σ pikëve	Σ /Nr. e të anketuarve
	X 1 pikë	X 2 pika	X 3 pika	Σ	$\Sigma/216$
1	20	28	546	594	2.75
2	23	64	483	570	2.63
3	60	68	456	584	2.70
4	42	82	462	586	2.71
5	52	42	507	601	2.78
6	158	86	291	535	2.47
7	68	42	483	593	2.74
8	66	42	486	594	2.75
9	128	86	327	541	2.50
10	32	104	444	580	2.68
11	72	42	477	591	2.73
12	20	58	531	609	2.81
13	52	104	414	570	2.63
14	54	46	498	598	2.76
15	44	54	531	629	2.91
16	20	52	540	612	2.83
17	28	32	558	618	2.86
18	56	78	447	581	2.68
19	60	94	417	571	2.64
20	58	74	450	582	2.69
Σ					54,25
$\Sigma/20$					2,71

Nga përgjigjet e dhëna nga të anketuarit në 20 pyetjet (pohimet), mund të konkludohet se, sipas të anketuarve, Republika e Maqedonisë ka mosmarrëveshje me Republikën e Bullgarisë në lidhje me gjuhën dhe historinë të cilat mbështesin hipotezën e parë ndihmëse.

Vlen të përmendet gjithashtu se është konfirmuar hipoteza e dytë ndihmëse, e cila thoshte se Republika e Maqedonisë ka probleme me Republikën e Sërbisë në sferën fetare, për shkak të mospranimi të autoqefalitetit të Kishës Ortodokse Maqedonase nga ana e Kishës Ortodokse Sërbe.

Më tej, ashtu si dy hipotezat ndihmëse paraprake, konfirmohet hipoteza e mëposhtme ndihmëse, përkatësisht që Republika e Maqedonisë ka probleme serioze me çështjen e emrit, me fqinjin e saj jugor, pra me Republikën e Greqisë. Si rrjedhojë, mund të konkludohet se Republika e Maqedonisë ka një tendencë për të kapërcyer problemet e ndryshme politike me të cilat përballet, dhe se Republika e Maqedonisë, deri më sot, ka arritur progres dhe suksese të caktuara në arenën politike ndërkombëtare, pra në marrëdhëniet e saj me fqinjët, duke mbështetur hipotezat e katërt dhe të pestë ndihmëse.

Më në fund, sipas asaj që u tha më sipër, mund të konkludohet se konfirmohet hipoteza e përgjithshme e hulumtimit, përkatësisht që “R. e Maqedonisë ka marrëdhënie shumë të mira me fqinjët ku kryesisht jetojnë popullatë shqiptare, si Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës, e nga ana tjetër, ekzistojnë disa problematika të thella dhe pengesa politike me shtetet fqinje që nuk janë të banuara me popullatë shqiptare, si, Republika e Sërbisë, Republika e Bullgarisë dhe Republika e Greqisë”

PËRMBYLLJE

Hyrja në dekadën e tretë të pavarësisë për Republikën e Maqedonisë është edhe një arsye për të festuar të gjitha sukseset gjatë njëzet viteve të fundit, por edhe një motiv tjetër për t'u rikthyer në atë që ka kaluar demokracia (ende e re), dhe mundësia për të mësuar mësim nga ajo e kaluar relativisht e shkurtër.

Krijimi i një shteti të pavarur gjithashtu çon në mënyrë të pashmangshme në krijimin e një politike të pavarur dhe shërbimi diplomatik, i cili ishte një nga aspektet më të rëndësishme të procesit të përgjithshëm të pavarësisë. Duke pasur parasysh rrethanat e rajonit tonë, marrëdhëniet e vendeve fqinje dhe (jo)përvojën e shërbimeve në atë kohë - kjo sfidë do të jetë një problem për shumë elita në pushtet, dhe disa aspekte të saj janë të pranishme edhe sot.

Mbijetesa e shteteve të vogla është një problem që nuk zgjidhet lehtësisht, dhe në Ballkan është komplikuar shumë më tepër në çështjet me karakter historik dhe etniko-fetar i cili ka lënë gjurmë të përhershme që nga rrënia e ish- Jugosllavisë. Në politikën e jashtme maqedonase gjatë dy dekadave të kaluara, kanë qenë të pranishme më shumë çështje dhe shumica e tyre mund të thuhet që janë prezente edhe sot – duke filluar nga qëllimi primar i njohjes së pavarësisë ndërkombëtarisht dhe anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare përmes “ekuidistancës” dhe definimit të prioriteteve të politikës së jashtme, e deri në forcimin e diplomacisë publike dhe ekonomike në vitet e fundit.

Duket se çështja -kontesti i imponuar nga Greqia, dominon gjatë gjithë periudhës, dhe ky dominim u bën trysni çështjeve tjera që do të ishin të zakonshme në një situatë “normale” - kur ai kontest nuk do të ekzistonte. Kjo çështje ka ngadalësuar njohjen ndërkombëtare, anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, pranimin në BE dhe NATO, vendosjen e marrëdhënieve bilaterale me disa vende, dhe kujdesin e maqedonasve në vendet fqinje, madje edhe disa aspekte të bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar.

Nëse njohja dhe çështjet në lidhje me të mund të thuhet se kanë apsolvuar, anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe NATO - megjithëse gjithmonë ishte në krye të prioriteteve - me siguri do të mbetej i porealizuar edhe për disa vite të tjera, duke pasur parasysh rrethanat në vetë organizatat (mbi të gjitha në BE) edhe pse Republika e Maqedonisë së Veriut u bë pjesë e NATO-s (në periudhën derisa ishte duke u punuar ky hulumtim shkencor) por jo edhe pjesë e

BE. Kjo është një shprehje e një situatë në të cilën edhe pse vendi i plotësonte kriteret për anëtarësimin në NATO dhe fillimin e negociatave për anëtarësim në BE – prosperiteti në këtë drejtim ka qenë i kufizuar nga abuzimi i pushtetit të vetos nga një shtet që është anëtar i këtyre dy organizatave (Greqia). Zgjidhja e kësaj mosmarrëveshje të gjatë të imponuar ishte përcaktim për elitat politike, megjithëse ekzistonte ndryshim në metodologjinë që do të zbatohet. Sidoqoftë, ka të ngjarë që të gjithë të bien dakord që për të përmirësuar pozicionet nacionale, është e nevojshme të forcohen kapacitetet e mundëshme për këtë qëllim, duke e ditur që është absurde të pritet që faktorë të jashtëm do të balancojnë fuqinë e palës tjetër në mosmarrëveshje.

Ashtu edhe ndodhi. R. e Maqedonisë së Veriut u bë antare e 30-të e NATO-s me këtë dinamikë të ndodhive:

- 15.11.1995 Partneritet për paqe
- 19.04.1999 Plani i veprimit për antarsim
- 11.07.2018 Thirrja për antrasim
- 06.02.2019 Protokoli për pranim
- 19.03.2020 Traktati hyn në fuqi
- 27.03.2020 Anëtare e plotë e NATO.

Poashtu më 24.03.2020, pas 20 vite proces stabilizim-asocimit, 15 vite si vend kandidat, 27 vendet antare të BE japin dritën jeshile për fillim të negociatave për antarsim të R. së Maqedonisë së Veriut në BE, pa asnjë kusht plotësues për vendin.

Nata ndërmjet 26 dhe 27.03.2020 ishte nata ku kryeministrat e vendeve anëtare në Këshillin Evropian aprovuan vendimin e ministrave për fillimin e bisedimeve.

Ceremonia e ngritjes së flamurit do të bëhet me 30 mars 2020 në Mons (Belgjik) dhe në Norfolk (SHBA)

“Maqedonia e Veriut tashmë është pjesë e familjes së NATO-s, familja e tridhjetë kombeve dhe afër 1 mlrd njerëzve. Një familje e bazuar në sigurinë që, pa marrë parasyshë me çfarë sfida ballafaqohemi, jemi më të fuqishëm dhe më të sigurtë së bashku.”- **Jens Stoltenberg**

Pas këtyre ngjarjeve me rëndësi për vendin tonë, mendoj që shtetin tonë dhe popullin tonë e pret një e adhme e mirë dhe premtuese.

Mes çështjeve të ngritura gjatë dy dekadave të fundit përfshihen edhe probleme që lidhen me marrëdhëniet fqinjësore me Bullgarinë (njohja e veçorive kombëtare dhe gjuhës); me Sërbinë (për njohjen e Kishës Ortodokse Maqedonase - Autoqefalitetit); si me Shqipërinë (për njohjen e të drejtave të pakicës maqedonase në këtë vend).

Marrëdhëniet me shtetin e sapoformuar të Kosovës ndikohen nga raste individuale të ekstradimit të të dyshuarve për krime të rënda, të cilat duhet të zgjidhen me vullnet politik nga të dy palët, dhe të presin formimin dhe funksionimin e plotë të sistemit juridik të shtetit fqinj. Në vitet e ardhshme, diplomacia maqedonase duhet të përqëndrohet në konsolidimin e vet dhe të përmirësojë vazhdimisht perceptimin e shtetit në plan të jashtëm, si dhe perceptimin e rëndësisë së tij në plan të brendshëm.

Ndër të tjera, problemet që politika jonë e jashtme është përballur në dy dekadat e kaluara, kanë të bëjnë me disa nga problemet me të cilat është përballur e gjithë shoqëria: dominimi i politikave dhe direktivat e partive në administratë; dukshmëria në ndarjet dhe dallimet etnike; mungesa e mjeteve financiare; mungesa e stafit profesional; ndryshimi i prioriteteve sipas ndryshimit të elitës politike në pushtet; injorimi i trendeve bashkëkohore në diplomaci; frenimi i veprimtarive të politikës së jashtme të integrimi evropiane dhe euro-atlantike; vonesa në krijimin e partneriteteve bilaterale; bashkëpunim i pamjaftueshëm me komunitetin akademik dhe sektorin civil; etj. Në dekadën e tretë, ekzistojnë ende disa çështje të hapura që duhet të plotësohen për të përcaktuar politikën e jashtme në mënyrë që ajo të jetë funksionale dhe efektive në skenën ndërkombëtare. Situata aktuale në politikën e jashtme maqedonase është rezultat i të gjitha reformave të deritanishme, por ashtu si në shumë fusha të tjera, nevojitet modernizim i mëtejshëm dhe përshtatje me rrethanat bashkëkohore.

Përkushtimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut për marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë është rinovuar me një entuziazëm të ri, një vizion të qartë dhe aktivitete konkrete. Marrëdhëniet transparente dhe të hapura, bazuar në respektin e ndërsjellë dhe bashkëpunimin reciprok të dobishëm, ndërtohen me të gjitha vendet fqinje: Shqipërinë, Bullgarinë, Greqinë, Kosovën dhe Sërbinë. Tashmë është bërë përparim i rëndësishëm në këtë drejtim.

LITERATURA E KONSULTUAR:**Libra**

1. Abdullahi, J, “Politika dhe politikat publike”, Arbëria Design 2016
2. Byman, D. “Deadly Connections: States that Sponsor Terrorism”. Cambridge University Press, 2005
3. Janev, I., “International relations and foreign politics (ëith the example of Yugoslav relations ëith the United Nations)”, Institute of Political Studies, Belgrade, 2002.
4. Janev, I, “Theory of international relations and foreign politics”. publ.: “Plato”, Belgrade, 1998
5. Ortakovski, V, “Interethnic relations and minorities in the Republic of Macedonia”, St. Cyril and Methodius University, Skopje
6. Rexhepi, Z, “Zhvillimet politiko-shoqërore te shqiptarët në Maqedoni 1990 – 2001” Tringa Design, Tetovë 2005
7. Sean, D. Murpfy, “Principles of International Law” Concise hornbook series, Thomson
8. Vukadinović, R. “Međunarodni politički odnosi”, Zagreb, 1998
9. Андов С., “На мој начин”, Матица Македонска, Скопје 2003
10. Габер, В. “Од објект до субјект Македонија во меѓународните односи”, Friedrich Ebert Stiftung, Скопје, 2017
11. Георгиевски, С и Додевски, С, Документи за Република Македонија 1990-2005, Правен Факултет „Јустинијан Први”, Скопје 2008
12. Петреска, Д, Ачкоска, В, Пешевска, М. “Историја за четврта година реформирано гимназиско образование”. Скопје. 2005, Табернакул
13. Поповски В, Ѓорѓиев В, Тодоровски З, Ачкоска В. “Создавањето на современата македонска држава”, „Македонска реч”- „Македоника литера”, Скопје 2014
14. Тилев, Д. “Регионална соработка во процесот на интеграција на Балканот во Европската Унија”. Универзитет Св. Кирил и Методиј, Правен факултет, Скопје, 2004
15. Тунтев А., Република Македонија – прва декада (1990-1999), Ми-Ан, Скопје 2005
16. Шкарик С, “Македонија на сите континенти”, Унион Трејд, Скопје 2000

Revista, gazeta dhe buletine

1. “Revista Brasileira de Política Internacional”, vol.54
2. “Нова Македонија”, Shkup, 29 qershor 1994
3. “ОГЛЕДАЛО”, СПИСАНИЕ ЗА ПРАВОСЛАВНА ВЕРА, КУЛТУРА, ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА, Тетовско-гостиварска епархија, Двоброј 8/9 · Декември 2017,
4. “Утрински весник”, бр. 5369 сабота, 29 април 2017
5. Astri Suhrke, Michael Barutciski, Peta Sandison, Rick Garlock, UNITED NATIONS HIGH COMMISSIONER FOR REFUGEES EVALUATION AND POLICY ANALYSIS UNIT, “The Kosovo refugee crisis”, 2000
6. KIPRED (Kosovar Institute For Polisy Research And Development- Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave) “Analizë e Politikave”, Nr.3/14, Maj 2014
7. Revista “Fokus” 20.01.2015

8. Revista javore “Globus”, nr.414 07.04.2015

Web

1. <http://javno.mk>
2. <http://pretsedatel.mk>
3. <http://star.vecer.com.mk>
4. <http://www.dijaspora.gov.rs>
5. <http://www.dw.de>
6. <http://www.globusmagazin.com.mk>
7. <http://www.hrw.org>
8. <http://www.kosovaelire.com>
9. <http://www.kosovothankyou.com>
10. <http://www.pp.gov.al>
11. <http://www.seep.ceu.hu>
12. <http://www.siofa.gov.mk> (Under construction now)
13. <http://www.slvesnik.com.mk>
14. <http://www.stat.gov.mk>
15. <https://akademik.mk>
16. <https://europeanwesternbalkans.com>
17. <https://fokus.mk>
18. <https://internationalrelations.sfsu.edu/what-ir>
19. <https://mfa.gov.mk>
20. <https://polisci.wisc.edu/fields/international-relations>
21. <https://respublica.edu.mk>
22. <https://sdk.mk>
23. <https://tv21.tv>
24. <https://vlada.mk>
25. <https://vlada.mk/vlada-ministerstva>
26. <https://www.balkanweb.com>
27. <https://www.bdi.mk>
28. <https://www.koha.net>
29. <https://www.mkd.mk>
30. <https://www.slobodnaevropa.org>
31. <https://www.sobranie.mk>
32. <https://www.sobranie.mk>
33. <https://www.unhcr.org>

SHTOJCA

Shkurtesat

OJQ- Organizata JoQeveritare
KB- Kombet e Bashkuara
FMN- Fondi Monetar Nderkombetar
BE- Bashkimi Evropian
SKJ- Savez Komunist Jugosllavije- lidhja komuniste jugosllave
UCK- Ushtria Clirimtare e Kosoves
UCK- ushtria CLirimtare Kombetare
UCPMB- Ushtria Clirimtare E Presheves Medvegjes dhe Bujanocit
MO- Marreveshja e Ohrit
RSFJ Republika Socialiste Federative e Jugosllavise
MNM- Makedonija na Makedoncite
KE- Komisioni Evropjan
NATO- North Atlantic Treaty Organization (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior)
JNA- Jugoslovenska Narodna Armija
APJ- Armata Popullore e Jugosllavisë
ACHOM- Антифашистичкото собрание на народното ослободување на Македонија
KOM- Kisha Ortodokse Maqedonase
KOS- Kisha Ortodokse Serbe
OA- Ohridska Arhiepiskopija
KOG- Kisha Ortodokse Greke
VMRO- Vnatreshna Makedonska Revolucionerna organizacija (Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase)
OKB- Organizata e Kombeve të Bashkuara
IRJM- Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
PASOK- Levizja socialiste panheleniste (parti politike greke)
FYROM (Former Yugoslavian Republic of Macedonia)
OSBE- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MIA - Medium Information Agency)

Pyetësi anketues

Të nderuar,

Ky pyetësor i anketës është anonim dhe mund të plotësohet sipas gjykimit tuaj. Bëhet fjalë për pyetje që janë pjesë e hulumtimit tim brenda tezës së masterit. Rezultatet e marra do të përdoren ekskluzivisht për qëllime hulumtuese të tezës së masterit me titull “*Marrëdhëniet e Republikës së Maqedonisë me fqinjët pas vitit 2001*”. Ju janë dhënë 20 pyetje apo pohime të cilave ju duhet të jepni mendime ose përgjigje.

Nr. Ren.	Pyetjet/ Pohimet	1	2	3
1	A mendoni se Republika e Maqedonisë ka disa mosmarrëveshje me Republikën e Bullgarisë?			
2	A jeni të informuar me problemet/çështjet që paraqesin sfida për Maqedoninë dhe Bullgarinë?			
3	Mendoj që problemi më i madh midis Maqedonisë dhe Bullgarisë është mosmarrëveshja për gjuhën dhe historinë.			
4	Marrëdhëniet që ka Maqedonia me Sërbinë mendoj se nuk janë mjaft të sinqerta dhe pozitive.			
5	A mendoni se problemi më i madh midis Maqedonisë dhe Sërbisë është mospranimi i autoqefalitetit të KOM?			
6	A mendoni që problemi fetar i Maqedonisë me Sërbinë do të zgjidhet ndonjëherë bashkarisht?			
7	A e shihni të rëndësishme funksionin mbështetës në punën tuaj?			
8	Mendoj që një prej mosmarrëveshjeve midis Maqedonisë dhe Sërbisë është edhe problemi që ka Serbia në lidhje me njohjen e Kosovës nga ana e Maqedonisë			
9	Mendoj se është e rëndësishme mbyllja e çështjes së emrit, Maqedonia dhe Greqia të arrijnë marrëveshje që do ta çojë Maqedoninë përpara.			
10	Mendoj që Maqedonia kishte problem serioz me mosnjohjen e emrit kushtetues të vendit nga ana e Greqisë			
11	Besoj se Republika e Maqedonisë ka shfrytëzuar maksimumin me marrëveshjen e arritur me Republikën e Greqisë dhe nuk ka më çështje të hapura midis dy vendeve.			
12	Trendi i tejkalimit të problemeve të ndryshme politike			

	me të cilat përballet Republika e Maqedonisë është i dukshëm			
13	Besoj që Republika e Maqedonisë deri më sot ka arritje dhe suksese të caktuara në skenën politike ndërkombëtare, pra në marrëdhëniet me fqinjët e saj.			
14	Besoj që Republika e Maqedonisë ka marrëdhënie jashtëzakonisht të mira me fqinjët e saj, ku kryesisht janë të banuara me shqiptarë.			
15	Besoj që Republika e Maqedonisë ka disa mosmarrëveshje dhe disa pengesa politike me shtetet që nuk kanë shumicë shqiptare.			
16	Mendoj që Republika e Maqedonisë ka marrëdhënie shumë të mira me Republikën e Kosovës dhe nuk kanë çështje të hapura dhe të pazgjidhura reciproke.			
17	Mendoj që Republika e Maqedonisë ka marrëdhënie shumë të mira me Republikën e Shqipërisë dhe nuk kanë çështje të hapura dhe të pazgjidhura reciproke.			
18	Mendoj që gjithmonë ka hapësirë për përmirësimin e politikave midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë.			
19	Mendoj që gjithmonë ka hapësirë për përmirësimin e politikave midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë			
20	Në përgjithësi, besoj që Republika e Maqedonisë ka aftësi të krijojë marrëdhënie të mira me të gjithë fqinjët e saj.			

Ju falemnderit !